

STRATEGJIA - PLAN VEPRIMI

**Për administrimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve
financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar**



FAZA I: 2023-2025

STRATEGJIA - Plan Veprimi

**Për administrimin dhe mbikëqyrjen
e rreziqeve financiare të lidhura me
klimën në sektorin financiar**

FAZA I: 2023-2025

SHKURTIMET

BSh	Banka e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
BIS	Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare - Bank for International Settlements
CO2	Dioksid Karboni
COP (KeP)	Konferenca e Palëve
CPRS	Sektorët me Ndikim në Politikat Klimatike - Climate Policy Relevant Sectors
CRER	Rreziqet Klimatike dhe Mjedisore - Climate-Related and Environmental Risks
EBA	Autoritetit Bankar Evropian
ESG	Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes
FI	Fonde Investimi
FP	Fonde Pensioni
GS	Gaze Serrë
IFJB	Institucione Financiare Jo Banka
KS	Kompani Sigurimi
MSME	Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme
NACE	Nomenclature statistique des Activités économiques dans la Communauté Européenne – Nomenklatura E Veprimtarive Ekonomike
NDC (KKP)	Kontributi Kombëtar i Përcaktuar
NGFS	Rrjeti Mbikëqyrës për Gjelbërimin e Sistemit Financiar
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
RoA	Kthim mbi Aktivitet - Return on Assets
RoE	Kthim mbi Kapitalin - Return on Equity
SDGs	Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm
SECO	Sekretariati Shtetëror Zvicëran për Çështjet Ekonomike
SHKK	Shoqëri Kursim-Kredi
TCFD	Task Forca për Zbulimet Financiare të lidhura me Klimën
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje	7
2.	Konteksti kombëtar i ndryshimeve klimatike	8
2.1.	Hapat që ka ndjekur qeveria shqiptare	8
2.2.	Hapat e ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë	9
3.	Tiparet kryesore të sektorit financiar shqiptar	10
3.1.	Sektori financiar: Të dhënat	10
3.1.1.	<i>Sektori financiar jobankar</i>	11
3.1.2.	<i>Karakteristikat e sektorit bankar shqiptar</i>	12
4.	Rreziqet financiare të lidhura me klimën në Shqipëri	13
4.1.	Rreziqet e klimës dhe kanalet e transmetimit të tyre në rrezikun ekonomik dhe financiar	17
5.	Sektori bankar shqiptar dhe rreziqet klimatike	19
5.1.	Reflektuar në mandatin e saj	19
5.2.	Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve klimatike	19
5.2.1.	<i>Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve fizike</i>	24
5.3.	Diskutimi i rezultateve të pyetësorit në sektorin bankar	27
5.4.	Sfidat për Bankën e Shqipërisë	28
6.	Plan Veprimi: Plani Strategjik i Gjellbër (2023-2025)	30
6.1.	Vizioni	30
6.2.	Objektivat	30
6.3.	Qëllimet	31
7.	Aktivitetet dhe kalendari i tyre	32
7.1.	Kultura / Aktivitetet e Bankës së Shqipërisë	32
7.1.1.	<i>Përkufizimi i qeverisjes së brendshme</i>	32
7.1.2.	<i>Qëndrimi i bankës qendrore</i>	33
7.1.3.	<i>Strategjia dhe plani i komunikimit</i>	33
7.2.	Rritja e kapaciteteve dhe kërkimi përkatës shkencor	34
7.2.1.	<i>Ngritja e kapaciteteve të BSH-së</i>	34
7.2.2.	<i>Raporti periodik i qëndrueshmërisë lidhur me ndryshimet klimatike</i>	34

7.3. Vlerësimi dhe matja e rrezikut	35
7.3.1. Përgatitja e një Paneli të gjelbër	35
7.3.2. Përgatitja e një ankete për ndërmarrjet mbi gjendjen e tregut të gjelbër	36
7.3.3. Përgatitja e një metodologjie për një vlerësim nga lart-poshtë të rreziqeve tranzitore	36
7.3.4. Ushtrimi i provës së rezistencës (stres test) – Prova e rezistencës nga lart-poshtë për rreziqet tranzitore	36
7.3.5. Vlerësimi në një moment kohor të caktuar të ekspozimit të sektorit bankar shqiptar ndaj rreziqeve fizike dhe atyre tranzitore	37
7.3.6. Përgatitja e një metodologjie për një vlerësim nga lart-poshtë të rreziqeve fizike	37
7.3.7. Prova e Rezistencës nga lart-poshtë për rreziqet fizike	38
7.4. Analiza makroekonomike dhe politika monetare	38
7.4.1. Ushtrimi i analizës së skenarit	38
7.5. Angazhimi kombëtar dhe ndërkombëtar	39
7.6. Rregullimi dhe mbikëqyrja bankare	39
7.6.1. Ngritja e kapaciteteve	41
7.6.2. Nxjerrja e udhëzuesit me pritshmëri rregullatore për rrezikun klimatik	41
7.6.3. Përgatitja e modeleve të raportimit	42
7.6.4. Bankat paraqesin vetëvlerësim për përputhjen me pritshmëritë mbikëqyrëse ndaj financave të gjelbra	42
7.6.5. Përgatitja e një metodologjie vlerësimi për modelin e raportimit, rishikimi i vetëvlerësimit dhe identifikimi i çështjeve që duhen trajtuar	42
7.6.6. Në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare	43
7.6.7. Bashkëpunime ndërkombëtare	43
7.6.8. Bashkëpunimi me institucionet vendase	43
8. Referenca	44
Aneks 1	45
Iniciativat ndërkombëtare	45
Kuadri ligjor i BE-së	46

Figura

Figura 1:	Marrëveshjet e Shqipërisë.	9
Figura 2:	Struktura e sektorit financiar, në % e totalit të aktiveve të sistemit financiar.	11
Figure 3:	Statistikat e rrezikut natyror për 1980-2020 – Numri i njerëzve të prekur.	14
Figura 4:	Kanalet dhe ndikimet e tërthorta të materializimit të rreziqeve fizike dhe tranzitore	18
Figura 5:	Pesha e sektorëve CPRS dhe sektorëve të tjerë në ekspozimin total të bankave në Shqipëri në vitet e fundit, 2016-2022	22
Figura 6:	Nënndarja e ekspozimit të bankave ndaj sektorëve me ndikim në politikat klimatike për periudhën 2016-2022	23
Figura 7:	Përmbledhja e rreziqeve kryesore dhe ashpërsisë së tyre	25
Figura 8:	Shpërndarja e degëve sipas rajonit.	26
Figura 9:	Pesha e huave sipas shtëpive në totalin e huave të familjeve sipas rajonit akorduar personave fizikë	27
Figura 10:	Kultura / aktivitetet e Bankës së Shqipërisë.	32
Figura 11:	Aktivitetet lidhur me ngritjen e kapaciteteve	34
Figurë 12:	Aktivitetet e vlerësimit dhe matjes së rrezikut	35
Figura 13:	Aktivitetet e angazhimit kombëtar dhe ndërkombëtar	39
Figura 14:	Aktivitetet e rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare	40

Tabela

Tabela 1:	Shpërndarja e kredisë bankare sipas sektorëve të ekonomisë rezidente.	12
Tabela 2:	Temperaturat e parashikuara dhe ndryshimet e reshjeve në Shqipëri	14
Tabela 3:	Klasifikimi i sektorëve sipas NACE	21
Tabela 4:	Përfundimet kryesore nga Vrojtimi mbi CRER për sektorin bankar.	28

FALENDERIME

Kjo strategji për administrimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar (faza e parë: 2023-2025), është një produkt i Bankës së Shqipërisë.

Strategjia është konceptuar nga stafi i Bankës së Shqipërisë në bashkëpunim të ngushtë me Grupin e Bankës Botërore (FinSAC).

“Ndryshimet klimatike [...] kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të fortë në faktorët e prodhimit dhe produktivitetin e tyre. Si të tilla, këto ndikime do të luajnë një rol vendimtar mbi çmimet dhe stabilitetin financiar në shkallë globale dhe duhet të mbeten në qendër të vëmendjes së bankave qendrore, si instrumente për çmimet dhe balancat financiare.”

Gent Sejko (2021)

1. HYRJJE

Ndryshimi i klimës ka nisur të rëndojë dhe do vazhdojë të jetë rëndesë gjithnjë e më shumë për bizneset dhe familjet shqiptare, duke ndikuar tek të gjithë agjentët ekonomikë, në të gjithë sektorët dhe shtrirjen gjeografike.

Sfidat me të cilat ndryshimet klimatike dhe kalimi në një ekonomi me emetime neto zero¹ e përballin ekonominë shqiptare dhe sistemin e saj financiar kërkojnë një planifikim dhe veprim të menjëhershëm nga autoritetet kombëtare, nëpërmjet transformimeve të rëndësishme strukturore dhe investimeve të rëndësishme në infrastrukturë dhe në masat e ndryshme të reduktimit dhe adaptimit ndaj këtyre rreziqeve. Kjo do të ndryshojë gjerësisht strukturat e ekonomisë shqiptare, duke krijuar rreziqe për disa aktivitete ekonomike, por duke hapur dhe mundësi.

Për arritjen e këtij qëllimi, kërkohet përfshirja dhe koordinimi i të gjitha institucioneve private dhe publike, përfshirë Bankën e Shqipërisë (BSh).

Rreziqet klimatike ndryshojnë nga rreziqet e tjera pasi ato kanë shtrirje më të gjerë, janë jolineare, të pakthyeshme dhe karakterizohen nga një pasiguri e thellë, edhe pse të parashikueshme. Por një gjë është e sigurt: kostot apo dëmi që do të shkaktojë mosveprimi do të jenë shumë më të mëdha se kostot që do të vijnë nga marrja e masave për të minimizuar rreziqet e ardhshme.

Sistemi financiar² luan një rol kyç në lidhje me ndryshimet klimatike. Së pari, sepse ndryshimet klimatike dhe tranzicioni janë burim rreziku për institucionet financiare. Së dyti, nuk ka zhvillim të qëndrueshëm pa financim të qëndrueshëm dhe ato janë kryesore në zbutjen e rreziqeve të ardhshme klimatike për Shqipërinë.

Sektori bankar ka gjasa të marrë rolin e udhëheqësit për kompanitë në Shqipëri, për shkak të natyrës së pazhvilluar dhe të cekët të tregjeve të kapitalit, jo vetëm duke “kanalizuar fondet”, por edhe duke “edukuar klientët” për të qenë më të qëndrueshëm.

¹ Është fjala për emetime neto zero të dioksidit të karbonit CO₂. Më pas do të shkruhet shkurtimisht “emetime neto zero”.

² I referohet bankave, jobankave dhe subjekteve të tjera të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Kjo është e nevojshme nëse duam të arrijmë qëndrueshmëri fiskale, të rrisim transparencën dhe në fund të hedhim bazat për një rritje të qëndrueshme ekonomike. Kështu që, nëse arrihet të miradministrohet, nga kalimi në një ekonomi me emetime neto zero mund të përfitojë potencialisht i gjithë vendi në planin afatgjatë. Megjithatë, këto ndikime lidhen drejtpërsëdrejti me disa pjesë të mandateve të bankave qendrore dhe adresimi i tyre paraqet disa sfida.

Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë është e interesuar të kuptojë më mirë pasojat ekonomike dhe financiare të ndryshimeve klimatike dhe kalimin në një ekonomi me emetim neto zero, si dhe përshtatjen e kuadrit të politikës të saj me këto ndryshime.

Kjo Strategji synon pikërisht këtë, duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe në rekomandimet dhe planet e veprimit të BE-së³. Pjesa thelbësore e strategjisë përfshin një plan veprimi, ku secili departament tregon angazhimet e ndërmarra për periudhën afatmesme 2023-2025, në kuadër të këtyre rreziqeve klimatike dhe rolin që duhet të luajë Banka e Shqipërisë. Duke qenë se rreziqet klimatike transmetohen në rreziqe financiare, roli i Bankës së Shqipërisë në identifikimin, monitorimin dhe administrimin e tyre është shumëplanësh. Prandaj, pjesa thelbësore e strategjisë përfshin një plan veprimi, i cili përmban një sërë aktiviteteve që do të ndërmerren nga departamente të ndryshme brenda Bankës së Shqipërisë, në varësi të mandatit dhe urgjencës së tyre për të vepruar.

2. KONTEKSTI KOMBËTAR I NDRYSHIMEVE KLIMATIKE


2.1. HAPAT QË KA NDJEKUR QEVERIA SHQIPTARE

Më poshtë paraqiten iniciativat dhe marrëveshjet aktuale kombëtare për luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj një bote me temperatura më të larta (Protokolli i Kiotos, Axhenda e OKB-së 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Marrëveshja e Parisit për Klimën etj.) dhe një rrugë drejt një zhvillimi me karbon të ulët dhe rezistent ndaj klimës.

Shqipëria ka ndërmarrë masa të nevojshme jo vetëm drejt anëtarësimit në BE dhe vendosmërisë për zbatimin e Deklaratës së Sofias, por edhe drejt arritjes së Objektiveve për Zhvillimin e Qëndrueshëm (SDG-të), ku më kryesoret pasqyrohen në figurën më poshtë (fig. 1).

³ Në Aneksin 1, mund të gjendet më shumë informacion mbi iniciativat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe planin e veprimit për financat e qëndrueshme të BE-së.

Figurë 1. Marrëveshjet e Shqipërisë



2.2. HAPAT E NDËRMARRË NGA BANKA E SHQIPËRISË

Në Shqipëri, financa e gjelbër është ende në fillimet e saj. Ajo ndodhet në fazën e “ngritjes së kapaciteteve” dhe “ndërgjegjësimit”.

Misioni i BSh-së, ai i ruajtjes së stabilitetit të çmimeve dhe stabilitetit financiar, përputhet plotësisht me Agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Që nga korriku 2017, banka është pjesë e “Rezolutës së Zhvillimit të Qëndrueshmërisë Global”, që nxjerr në pah rëndësinë e sektorit financiar në përmbushjen e Parimeve të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe projekteve të Marrëveshjes së Klimës së Parisit (COP21). Në dhjetor 2020, Banka e Shqipërisë iu bashkua Bankave Qendrore dhe Rrjeteve Mbikëqyrëse për Gjelbërimin e Sistemit Financiar (NGFS) duke e vënë theksin në përmbajtjen e “gjelbër”.

Këto vitet e fundit, Banka e Shqipërisë po ndjek zhvillimet klimatike për të arritur objektivat e saj dhe ka shfaqur vullnetin për të dhënë kontributin në nxjerrjen e analizave politike dhe/ose kërkimeve rreth çështjeve të ndryshimeve klimatike (studime kërkimore, indikatorë klimatik, produkte të dhënash të reja). Këto produkte kanë përfituar dhe nga bashkëpunimi me Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), Bankën Botërore (FinSAC), Vienna Initiative dhe pjesëmarrja aktive në rrjete ndërkombëtare.

Banka e Shqipërisë gjithashtu që prej vitit 2018 është angazhuar në modernizimin dhe digjitalizimin e tregut të pagesave me qëllim nxitjen e përfshirjes financiare dhe përdorimit të pagesave elektronike në ekonominë shqiptare. Një nga masat kryesore në këtë drejtim është dhe miratimi dhe zbatimi i ligjit “ Për shërbimet e

pagesave" i cili synon të ulë kostot, të promovojë konkurrencën dhe inovacionin në tregun e pagesave dhe të krijojë konceptin e "Openbanking" me qëllim nxitjen e aksesit të qytetarëve shqiptar në shërbimet e pagesave dhe promovimin e shërbimeve më efikase dhe me kosto më të ulët. Më konkretisht, bazuar në studime të Bankës së Shqipërisë përdorimi i cash-it në ekonominë shqiptare mbart një kosto prej rreth 1.8 % të PPB-së ndërkohë që transfertat elektronike që synon të promovojë ligji i kushtojnë ekonomisë shqiptare rreth 0.2% të PPB-së.

Në këtë linjë, digjitalizimi i shërbimeve ndërlidhet me financën e gjelbër duke kontribuar në reduktimin e kostove që mbart ekonomia shqiptare nga përdorimi i lartë i cash-it, reduktimi i infrastrukturës fizike të nevojshme për transaksionet bankare si dhe reduktimi i nevojave për konsum energjie. Kështu digjitalizimi i financës konsumon më pak burime dhe gjeneron më pak ndotje, duke krijuar potencial që ekonomia të funksionojë në mënyrë më efikase dhe të financojë projekte që mund të kanalizohen për ekonominë e gjelbër. Konsensusi në nivel ndërkombëtar tregon se përdorimi i shërbimeve financiare digjitale mund të kontribuojnë për të avancuar politikat gjithëpërfshirëse të financave të gjelbra. Për më tepër, studimet⁴ kanë treguar sesi zhvillimet inovative të tregut u mundësojnë familjeve me të ardhura të ulëta dhe rurale, si dhe sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (MSME), të rrisin qëndrueshmërinë e tyre ndaj rreziqeve mjedisore dhe t'i përshtaten ndryshimeve klimatike nëpërmjet shërbimeve financiare digjitale.

Të gjitha këto tregojnë për seriozitetin dhe rëndësinë që Banka e Shqipërisë i ka kushtuar dhe do të vazhdojë t'i kushtojë qëndrueshmërisë në financë për një ekonomi më të gjelbër dhe më gjithëpërfshirëse.

3. TIPARET KRYESORE TË SEKTORIT FINANCIAR SHQIPTAR⁵


3.1. SEKTORI FINANCIAR: TË DHËNAT

Sektori financiar shqiptar përbëhet nga 11 banka, 38 institucione financiare jobanka (IFJB), 16 shoqëri kursim-kredi (SHKK), 12 shoqëri sigurimesh, 12 fonde investimi dhe 5 fonde pensioni. Aktivet e sektorit bankar përbëjnë 89.5% të totalit të aktiveve financiare dhe rreth 92% të PBB-së. Sektori financiar jobankar zë 10.5% të totalit të aktiveve financiare dhe 10.8% të PBB-së. Aktivet e institucioneve financiare jobanka zënë peshën kryesore në aktivitetin e sektorit jobankar (rreth 3.9%), të ndjekura nga fondet e investimeve (3.5%) dhe korporatat e sigurimeve (2.1%).

⁴ <https://www.afi-global.org/newsroom/blogs/how-digital-financial-services-can-move-the-needle-in-advancing-inclusive-green-finance/>

⁵ Të dhënat janë të muajit qershor 2022

Figurë 2. Struktura e sektorit financiar, në % të totalit të aktiveve të sistemit financiar



3.1.1. SEKTORI FINANCIAR JOBANKAR

Aktiviteti kryesor i institucioneve financiare jobankare (IFJB) është kreditimi, i ndjekur nga pagesat dhe transfertat. Individët zënë rreth 54% të portofolit të kredisë të dhënë nga IFJB-të. Nga pjesa e mbetur prej 46% e kredive të dhëna për ndërmarrjet, sektori më i financuar është ai i tregtisë me shumicë dhe pakicë, 19%, i ndjekur nga aktivitetet e tjera të shërbimit me 16%. Kapitali i IFJB-ve përbëhet nga 70% kapital shqiptar dhe 30% kapital i huaj.

Aktiviteti kryesor i shoqërive të kursim kredive (SHKK) është investimi në kredi (69%) dhe investimi në depozita me afat në banka (21%). Sektori që ka tërhequr financimin më të madh nga aktiviteti i anëtarëve është sektori i bujqësisë (36%), i ndjekur nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë (13%). Kapitali i SHKK-ve është tërësisht shqiptar.

Tregu i kompanive të sigurimit (KS) dominohet nga sigurimet e jojetës që përbëjnë rreth 92% të primeve të sigurimit. Tregu i KS-ve përbëhet nga 65% sigurim motorik, 19% pasuri të paluajtshme dhe të tjera, dhe 16% sigurim i jetës dhe shëndetit. Aktiviteti kryesor i tregut të KS-ve janë depozitat me afat dhe llogaritë bankare (33%), të ndjekura nga investimet në pasuri të paluajtshme (15%), investimet në letra me vlerë (12%) dhe aksionet (9%). Rreth 79% e kapitalit është shqiptar, ndërsa 21% e kapitalit është i huaj.

Aktiviteti kryesor i Fondeve të Pensionit (FP) është investimi financiar i mbajtur deri në maturim (89%). Kapitali përbëhet nga 55% kapital shqiptar dhe 45% kapital i huaj.

Fondet e Investimeve (IF): Fondet e Investimeve administrohen nga 5 shoqëri administruese dhe zotërojnë aktive neto që llogariten në 71 miliardë lekë. Aktiviteti kryesor i FI-ve janë letrat me vlerë me 88% të totalit të aktiveve, të ndjekura nga para fizike dhe llogaritë rrjedhëse (11% e totalit të aktiveve).

3.1.2. KARAKTERISTIKAT E SEKTORIT BANKAR SHQIPTAR

Shpjegimi i karakteristikave kryesore të sektorit bankar shqiptar (pronësia, cilësia e aktiveve, përfitueshmëria, aftësia paguese, likuiditeti etj.) sipas të dhënave të muajit qershor 2022.

Sektori bankar zë peshën më të rëndësishme në sistemin financiar në Shqipëri me aktive rreth 1800 miliardë lekë dhe përbën rreth 90% të totalit të aktiveve financiare. Sipas origjinës së kapitalit, rreth 30% e totalit të aktiveve të sektorit bankar është kapital shqiptar (4 banka) dhe 70% kapital i huaj (8 banka).

Sipas kontributit marginal në rrezikun sistematik në Shqipëri, bankat klasifikohen si banka me rëndësi sistemike, të cilat përbejnë rreth 60% të totalit të aktiveve të sektorit bankar dhe të bankave të tjera.

Sektori bankar karakterizohet nga një nivel i përshtatshëm kapitalizimi, duke pasur një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit rreth 19%. Kreditimi, si aktiviteti kryesor i sektorit bankar, zë rreth 40% të totalit të aktiveve të sektorit bankar, i ndjekur nga operacionet e letrave me vlerë (rreth 30%), dhe operacionet e thesarit dhe ato ndërbankare (27%). Stoku i kredive të dhëna nga sektori bankar gjatë gjatshëmujorit të parë të 2022 arriti në 700 miliardë lekë. Kredia për subjektet rezidente përbën 96% të teprcës së kredisë. Kreditë e dhëna për sektorin privat (bizneset) përbëjnë 63% të totalit të kredive, ndërsa kreditë për individët 34%. Peshën kryesore të kredisë për bizneset rezidente e zë kredia për investime për pasuri të paluajtshme dhe kredia për blerje pajisjesh, secila 30% të stokut të kredive dhënë bizneseve. Kredia për blerjen e pasurive të paluajtshme zë peshën kryesore në portofolin e kredisë së individëve, me 66%. Kreditë me probleme zënë 5% të totalit të kredive, me një kontribut prej 4% të kredive me probleme nga bizneset dhe 1% nga individët.

Tabelë 1: Shpërndarja e kredisë bankare sipas sektorëve të ekonomisë rezidente

	Bujqësia	Industria përpunuese	Energjia elektrike, gaz, ajri i kondicionuar	Furnizim me ujë	Ndërtimi	Tregtia me shumicë dhe pakicë	Transporti	Akomodimi	Të tjera	Individë/kredi për prona të paluajtshme	Individë/kredi të tjera
% e kredive në sektorin bankar	1.0%	8.8%	7.9%	0.4%	10.3%	20.2%	1.4%	5.1%	7.8%	21.7%	11.4%

Sektori bankar shqiptar ka një nivel favorizues të pozicionit të likuiditetit prej 40% të aktiveve likuide ndaj detyrimeve me maturim të mbetur deri në 1 vit. Treguesit e likuiditetit në lekë (57%) dhe valutë (26%) mbeten ndjeshëm mbi kërkesat minimale rregullatore.

Rezultati financiar neto i sektorit bankar rezulton në shifrën 6.5 miliardë lekë. Treguesit e përfitueshmërisë gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2022 janë RoA 0.7% dhe RoE 7.2%. Të ardhurat neto nga interesat e sektorit bankar përfaqësojnë zërin kryesor të të ardhurave, ndërsa shpenzimet pa interesa mbeten zëri kryesor i shpenzimeve.

4. RREZIQET FINANCIARE TË LIDHURA ME KLIMËN NË SHQIPËRI


Bankat janë të ekspozuara ndaj rreziqeve financiare të lidhura me klimën, nëpërmjet dy kanaleve kryesore, rreziqeve fizike dhe rreziqeve të tranzicionit. Rreziqet fizike burojnë drejtpërdrejt nga ndryshimet klimatike, ndërsa rreziqet e tranzicionit lindin nga reagimi – nga politikëbërësit, novatorët ose konsumatorët – për të parandaluar dhe/ose luftuar ndryshimet klimatike.

Rreziqet fizike i referohen efekteve si të rritjes së temperaturave ashtu edhe të ngjarjeve ekstreme të motit, të cilat po bëhen gjithnjë e më të shpeshta. Ato mund të ndahen në rreziqe akute dhe kronike: rreziqet akute janë ngjarje të papritura të shkurtra dhe të rënda që kanë një ndikim të rëndësishëm negativ, p.sh. reshjet e mëdha të shiut që shkaktojnë përmytje. Rreziqet kronike pasqyrojnë përkeqësimin e vazhdueshëm të kushteve ekologjike, p.sh. rritjen e nivelit të detit. Rreziqet fizike, të cilat mund të dëmtojnë infrastrukturën materiale dhe investimet fikse, prirën të ndryshojnë nga rajoni në rajon, duke prekur, p.sh. zonat bregdetare në mënyrë të ndryshme nga rajonet e akullnajave. Rreziqet fizike të lidhura me klimën bien në kategori më tradicionale në administrimin e rrezikut financiar. Në momentin që rreziqet fizike materializohen, ato mund të shkatërrojnë aktivet menjëherë ose gradualisht, p.sh. duke shkaktuar përshpejtimin e normës së amortizimit të kapitalit, nëpërmjet shkatërrimit ose korrozionit. Nëse aktivet e prekura janë lënë si kolateral për një hua, rreziku i kredisë që lidhet me këto aktivitete do të rritet. Shumë rreziqe fizike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën: nëse, për shembull, përmytjet e rënda shkatërrojnë një pjesë të konsiderueshme të kolateralit të pasurive të paluajtshme në një zonë të caktuar, huadhënësit në atë rajon mund të përballen me rrezik më të lartë përqendrimi. Nëse çmimi është në përputhje me rrethanat, pasiguria në rritje për shkak të ndryshimeve klimatike mund të çojë gjithashtu në prime më të larta të rrezikut mbi normat e interesit, gjë që, nga ana tjetër, rrit rrezikun e tregut.

Rreziqet fizike nuk janë vetëm rreziqe të së ardhmes, ato tashmë po ndikojnë në ekonominë dhe sistemin financiar sot dhe Shqipëria tashmë po përjeton ndryshimet klimatike, si një nga vendet më të cënueshme ndaj ngjarjeve akute të motit – përmytjet, thatësirat, valët e të nxehtit dhe zjarret – në Ballkanin

Perëndimor, sipas Bankës Botërore dhe Indeksit ND-GAIN⁶. Figura 3 ofron një pasqyrë të fatkeqësive natyrore më të shpeshta të ndodhura në Shqipëri dhe ndikimet e këtyre fatkeqësive tek popullsia.

Figurë 3. Statistikat e rrezikut natyror për 1980-2020 – Numri i njerëzve të prekur



Burimi: Banka Botërore (2020), <https://climateknowledgeportal.worldbank.org/country/albania/vulnerability>

Vlerësohet se rreziqet fizike do të rriten, si në intensitet ashtu edhe në frekuencë, në Shqipëri gjatë viteve në vazhdim. Tendencat e rritjes së temperaturës dhe uljes së reshjeve ka të ngjarë të vazhdojnë sipas të dy skenarëve: ajo e Ministrisë së Mjedisit në Shqipëri, dhe e Bankës Botërore (Shih Tabelën 2). Prandaj, identifikimi, matja dhe monitorimi i këtyre rreziqeve nga institucionet financiare do të jetë një aktivitet i pashmangshëm në vitet në vijim dhe për rrjedhojë, edhe përfshirja e tyre në veprimet e Bankës së Shqipërisë.

Tabelë 2: Temperaturat e parashikuara dhe ndryshimet e reshjeve në Shqipëri

		Horizonti kohor			
		2025	2050	2100	
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Shqipërisë	Temperaturat vjetore (°C)	+0.8 to +1.1	+1.7 to +2.3	+2.69 to +5.3	
	Precipitimi vjetor (%)	-3.4 to -2.6	-6.9 to -5.3	-16.2 to -8.8	
		2020-2039	2040-2059	2060-2079	2080-2099
Banka Botërore	Temperaturat vjetore (°C)	+0.4 to +2.3	+1.1 to +3.6	+1.8 to +5.0	+2.7 to +6.9
	Precipitimi vjetor (%)	-18.0 to -10.5	-23.0 to -10.0	-27.5 to +8.6	-33.2 to +5.8

Rreziqet tranzitore lidhen me përpjekjet për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike, si pjesë e tranzicionit nga mënyrat aktuale të prodhimit në një ekonomi më miqësore ndaj klimës. Ulja e emetimeve të CO₂, në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Parisit, kërkon politika të synuara klimatike (p.sh. taksat e karbonit), ndryshime në ligje dhe rregullore, si dhe risi teknike dhe ndryshime në sjelljen e konsumatorëve. Megjithatë, tranzicioni i çrregullt për shkak të një prezantimi me vonesë të politikave klimatike apo prezantimi i tyre në mënyrë jo të koordinuar në qytete, mund të shkaktojë mungesën e përfshirjes së këtyre ndikimeve nga investitorët dhe rrjedhimisht shfaqjen e burimeve të reja të rreziqeve financiare. Një tranzicion i çrregullt mund të shkaktojë një rritje të paqëndrueshmërisë së

⁶ Universiteti i Notre Dame (2020). *Iniciativa Globale e Përshtatjes Notre Dame*. URL: <https://gain.nd.edu/our-work/country-index/>

çmimeve të aktiveve (si negative për aktivitetet me karbon të lartë dhe pozitiv për aktivitetet me karbon të ulët) me implikime për paqëndrueshmëri financiare, nëse përfshihen klasa të mëdha dhe të ndërlidhura të aktiveve.⁷

Ndryshimet rregullatore mund të ndryshojnë çmimet relative të mënyrave të prodhimit me karbon të ulët dhe gri. Shembuj të politikave që përmbajnë kosto negative jo të drejtpërdrejta klimatike përfshijnë çmimet e karbonit dhe skemat e tregtimit të emetimeve ku mund të vendosen tarifa për emetimin e gazeve serrë (GS). Megjithatë, këto politika mund të ulin kapacitetin e shërbimit të borxhit të emetuesit, kështu që aksionet dhe obligacionet e kompanive që emetojnë GHG do të ulen, në përputhje me rrethanat.

Më tej, përhapja e teknologjive neutrale ndaj klimës mund të veprojë si një pikë kthese për tregjet dhe të transformojë investimet që më parë kanë qenë me vlerë në aktivet e bllokuara, vlera e të cilave nuk është më e sigurt, pasi ato nuk mund të përdoren për shkak të barrierave rregullatore, sociale ose teknike. Inovacioni teknologjik mund të zvogëlojë kostot e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe të bëjë këto të fundit më konkurruese kundrejt lëndëve djegëse fosile, të cilat janë një burim kryesor i emetimeve të GS. Nga ana tjetër, kompanitë e qymyrit ose të naftës që kontabilizojnë rezervat e paekstraktuara në bilanci të tyre përballen me rreziqe të konsiderueshme negative në lidhje me çmimet e ardhshme të këtyre aktiveve në rast se përparimet teknologjike i kthejnë rezervat në aktive të bllokuara. Përhapja e përshpejtuar e paneleve diellore me kosto të ulët ose e pajisjeve të lëvizshmërisë elektronike ka potencial të shkëpusë, duke nxjerrë jashtë loje makineritë tradicionale që emetojnë GS. E fundit, rritja e ndërgjegjësimit për ngrohjen globale mund të ndryshojë preferencat e konsumatorëve dhe kështu të zvogëlojë kërkesën për mallra me intensitet karboni, duke i kthyer me shpejtësi aktivet me rendiment të lartë në aktive të bllokuara. Një zhvlerësim i madh i aktiveve me bazë karboni dhe të ardhura më të ulëta për debitorët, për shkak të zhvendosjeve të kërkesës, do të thotë se bankat përballen me një probabilitet më të lartë të mospagimit të disa prej kredive të tyre. Në varësi të momenteve të ndryshimeve të opinionit nga qeveritë, kompanitë dhe konsumatorët, tranzicioni mund të rezultojë në një "ulje të butë" ose një "ulje të vështirë". Kjo e fundit do të sillte aktive (asete) në një kohë kur ka gjasa të materializohen gjithnjë e më shumë rreziqet fizike.

Shqipëria është e angazhuar për të shkuar drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe ka filluar të veprojë për t'a arritur këtë objektiv. Në nivel global, Shqipëria u angazhua në kuadër të zbatimit të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, mbështetur nga Kombet e Bashkuara dhe për të përmbushur Kontributet e Përcaktuara Kombëtare (NDC-të) sipas Marrëveshjes së Parisit⁸. Në nivel rajonal, së bashku me

⁷ Monasterolo, I., S. Battiston, A.C. Janetos and Z. Zheng. 2017. *Vulnerable yet relevant: the two dimensions of climate-related financial disclosure*. In: *Climatic Change* 145. 495–507.

⁸ Me objektivin për të reduktuar me 20.9% GS midis 2016 dhe 2030. Qeveria dhe Zyrtarët e Ndryshimit Klimatik (CCU-të) të saj janë përgjegjëse për të monitoruar emetimet e GS.

ekonomitë e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria ka nënshkruar Agjendën e Gjelbër të përshkruar gjatë Samitit të Sofjes në vitin 2020, e cila përputhet me Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së⁹. Në nivel vendi, në vitin 2019, Shqipëria ishte vendi i parë i Ballkanit Perëndimor që miratoi një strategji kombëtare dhe plan veprimi për ndryshimin e klimës, edhe pse NDC aktuale trajton vetëm reduktimin e emetimeve dhe jo masat e përshtatjes. Të gjitha këto marrëveshje tregojnë rrugën e qartë që ka Shqipëria drejt ekonomisë së qëndrueshme dhe parashikojnë një sërë veprimesh që do të shkaktojnë shfaqjen e rreziqeve tranzitore.

Kryesisht, kalimi në një ekonomi të qëndrueshme do të kërkojë ndryshime të thella sektoriale, veçanërisht në sektorët e energjisë dhe bujqësisë. Nevojiten më shumë investime – në efikasitetin e energjisë, energjinë e rinovueshme dhe përshtatjen rezistente ndaj klimës për bujqësinë dhe menaxhimin e ujit - për të rritur fleksibilitetin e vendit ndaj ndryshimeve klimatike.

Megjithëse rreziku fizik dhe ai tranzitor konsiderohen si rreziqet kryesore të lidhura me klimën, ekzistojnë gjithashtu rreziku i përballjes në gjykatë që mund të lindin nga njerëzit ose bizneset që kërkojnë kompensim për humbjet që mund të kenë pësuar nga rreziqet fizike ose tranzitore nga ndryshimet klimatike të përshkruara më sipër ose sfidat ligjore të marra për të kërkuar një kurs të caktuar veprimi. Ndërsa rreziqet e çështjeve gjyqësore ishin identifikuar më parë si një kanal më vete, ato konsiderohen gjithnjë e më shumë si një nënkategori e rreziqeve fizike dhe tranzitore.

Karakteristikat kryesore të rreziqeve të lidhura me klimën janë:

- ato janë sistemike dhe do të kenë ndikim tek çdo konsumator dhe çdo kompani në të gjithë sektorët dhe në të gjithë shtrirjen gjeografinë. Ndikimi i tyre ka të ngjarë të jetë i ndërlidhur, jolinear, i pakthyesëm dhe do të jetë subjekt i pikave të kthesës që do të ndërmerret. Prandaj, ato do të ndodhin në një shkallë shumë më të madhe sesa rreziqet e tjera që kompanitë janë mësuar të modelojnë dhe menaxhojnë;
- ato janë të paqarta dhe, njëkohësisht, ende plotësisht të parashikueshme. Rreziqet nuk mund të shmangen, por vendimet për reduktimin e emetimeve do të ndikojnë në kombinimin e rreziqeve fizike me ato të tranzicionit që do të shfaqen;
- veprimi i hershëm në kohë mund të ndihmojë në zbutjen e madhësisë dhe ekuilibrit të rreziqeve të ardhshme. Në momentin që rreziqet fizike fillojnë të shfaqen në mënyrë sistematike, mund të jetë tepër vonë për të rikthyer shumë efekte nëpërmjet reduktimit të emetimeve.

⁹ Kjo Agjendë e Gjelbër përbëhet nga pesë shtylla kryesore: (i) dekarbonizimi (klima, energjia dhe lëvizshmëria); (ii) ekonomi rrethore; (iii) ndotja (ajri, uji dhe toka); (iv) bujqësi e qëndrueshme dhe prodhimi i ushqimit; dhe (v) biodiversiteti.

4.1. RREZIQET E KLIMËS DHE KANALET E TRANSMETIMIT TË TYRE NË RREZIKUN EKONOMIK DHE FINANCIAR

Hapi i parë për të kuptuar mënyrën se si rreziqet klimatike mund të shkaktojnë një çekuilibër financiar është identifikimi i kanaleve të transmetimit mes rreziqeve klimatike dhe atyre ekonomike e financiare, në ekonominë shqiptare dhe sistemin financiar. Nëse bankat qendrore dhe mbikëqyrësit financiarë i kuptojnë më mirë këto kanale identifikimi, vlerësimi dhe administrimi i rreziqeve – ndërsa këto të fundit po vijjnë duke u rritur si në madhësi ashtu dhe në frekuencë – bëhet më i thjeshtë.

Rreziqet klimatike mund të shndërrohen në rreziqe ekonomike dhe financiare¹⁰. Stabiliteti socio-ekonomik mund të vihet përballë rreziqeve dhe dëmeve të rënda për shkak të ndryshimeve klimatike, shkatërrimeve natyrore më të shpeshta dhe më të ashpra, rritjes së nivelit të detit, uljes së prodhueshmërisë dhe humbjeve të prodhimit, pasojave dëmtuese të shëndetit, sëmundjeve infektive, varfërisë dhe pabarazisë, si dhe çekuilibrit më të theksuar makroekonomik dhe financiar. Rrjedhimisht, angazhimi në këtë fushë duhet të jetë i menjëhershëm, në mënyrë që të shmangen dëmet e sipërpërmendura në të ardhmen¹¹. Duke vërejtur profilin mjedisor dhe ekonomik të Shqipërisë, dhe projektimet, të cilat shfaqin një rrezik të shtuar të shpeshtësisë, intensitetit dhe paparashikueshmërisë së dëmeve natyrore dhe hidrometeorologjike (të tilla si: furtuna, përmytje, valë të të nxehtit, zjarre), në Shqipëri identifikohen disa rreziqe ekonomike. Këto rreziqe janë më së shumti të lidhura me ndikimin që kanë ndryshimet klimatike në sektorin bujqësor, energjetik, menaxhimin e burimeve ujore, transport dhe zonat bregdetare. Rreziku klimatik ka gjasa të ushtrojë trysni edhe mbi shëndetin dhe rrjetet e mbrojtjes sociale.


Megjithatë, kuptueshmëria dhe vlerësimi i rreziqeve fizike dhe tranzitore në Shqipëri është ende në fazat fillestare. Rreziqet ekonomike të piketuara më sipër janë veçse një listë fillestare, që mund të shërbejë si bazë për studime të mëtejshme, dhe nuk duhet të konsiderohet plotësisht shteruese.

Ndryshimi dhe tranzicioni klimatik përbëjnë burim rreziku për institucionet financiare. Rreziqet klimatike kanë ndikim në zgjedhjet për investime, luhatshmërinë e PBB-së dhe rritjen potenciale ekonomike, punësimin dhe prodhueshmërinë, dhe nivelet e çmimeve, që lidhen drejtpërdrejtë me mandatin e bankave qendrore. Sipas BIS (2021), ato përkthehen në burime tradicionale rreziqesh për bankat, duke nxjerrë në pah rëndësinë e sektorit bankar në vlerësimin, monitorimin dhe trajtimin e duhur të tyre. Figura 4 paraqet kanalet përmes së cilave ndryshimet klimatike mund të ndikojnë stabilitetin ekonomik e financiar.

¹⁰ Bankat Qendrore dhe Rrjetet Mbikëqyrëse për Gjelbërimin e Sistemit Financiar (NGFS) i referohen zakonisht rreziqeve klimatike dhe mjedisore (Për përkufizime shiko NGFS 2020a). Në këtë raport, termi rreziqe klimatike i referohet rrezikut klimatik dhe mjedisor, duke qenë se për bankat qendrore dhe mbikëqyrësit rreziqet klimatike kanë të njëjtat implikime me rreziqet mjedisore (INSPIRE-NGFS 2022).

¹¹ Literatura konfirmon se humbjet në PBB janë mjaftueshëm të larta për të ndikuar në vlerat aktuale neto. Si pasojë, nevojiten veprime politike aktuale dhe të qëllimshme për të zbutur pasojat e ndryshimeve klimatike.

Figurë 4. Kanalet dhe ndikimet e tërthorta të materializimit të rreziqeve fizike dhe tranzitore



Burimi: Përshtatur nga BIS (2021).

Në Shqipëri rreziqet klimatike nuk janë adresuar ende plotësisht. Megjithatë, edhe pse në hapat fillestarë, sektori financiar shqiptar ka filluar të njohë rëndësinë e vlerësimit dhe adresimit të rreziqeve financiare të klimës. Ky proces kërkon ngritjen e kapaciteteve, për të ruajtur/arritur ritmin e Evropës dhe shteteve fqinje në këtë drejtim, si edhe për të siguruar stabilitetin dhe mundësinë për t'i shërbyer ekonomisë në të ardhmen.

Së fundmi, duke pasur parasysh që nga kriza të dalim të fituar, Shqipëria duhet të përfitojë nga mundësitë financiare (tregje të reja, instrumente financiare rishtarë), që do dalin në dritë falë Marrëveshjes së Gjellbër të BE-së dhe asaj paralele, Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, drejt një ekonomie më gjithëpërfshirëse, përbaluese ndaj sfidave dhe të qëndrueshme.

Banka e Shqipërisë do ketë një rol udhëheqës në këtë proces, të shtrirë në disa fusha që janë nën kujdesin e saj.

5. SEKTORI BANKAR SHQIPTAR DHE RREZIQET KLIMATIKE

5.1. REFLEKTUAR NË MANDATIN E SAJ

Ligji "Për Bankën e Shqipërisë" nr. 8269, i ndryshuar përcakton se objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është "të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve". Për të përmbushur këtë objektiv, nevojitet një panoramë e plotë me të gjithë faktorët ndikues të inflacionit. Ndryshimi klimatik ka një efekt ekonomik me shtrirje të gjerë, ndaj, është detyra jonë të kuptojmë pasojat e ndryshimeve klimatike dhe të periudhës tranzitore mbi dinamikën e çmimeve në Shqipëri, në mënyrë që të marrim vendime të mirinformuara.

Ligji përcakton se BSH-ja duhet të "... nxisë ruajtjen e likuiditetit, aftësinë paguese dhe funksionimin normal të sistemit bankar të bazuar në parimet e tregut." Ky është de facto një mandat i stabilitetit financiar. Ligji rendit masat që mund të ndërmarrë BSH-ja për të kontrolluar qasjen në sektorin bankar. Si pasojë, Banka e Shqipërisë është mbikëqyrësi dhe rregullatori i sistemit bankar shqiptar. Rreziqet klimatike ndikojnë tek rreziqe financiare (dhe anasjelltas) dhe, si të tilla, ndikojnë në mandatin e BSH-së (NGFS 2019). Në këto rrethana, BSH-ja duhet të ndjekë rekomandimet e NGFS-së për mbikëqyrjen.

Së fundi, Kushtetuta mandaton Bankën e Shqipërisë të "... ruajë dhe të administrojë rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë.". Si çdo aktiv tjetër financiar, edhe rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë ekspozohet ndaj rreziqeve financiare klimatike. Administrimi i përshtatshëm i këtyre rreziqeve ndikon edhe në administrimin e duhur të rezervave valutore.

5.2. EKSPOZIMI I SEKTORIT BANKAR NDAJ RREZIQEVE KLIMATIKE

Bankat ekspozohen ndaj rreziqeve financiare klimatike përmes aktiviteteve dhe operacioneve/transaksioneve të tyre. Për shembull, këto rreziqe mund të ndikojnë probabilitetin e mospagimit të huave, duke shkaktuar humbje financiare më të larta se pritshmëritë. Për më tepër, aktiviteti i kompanive mund të pësojë ndërprerje për shkak të rreziqeve fizike, të cilat mund t'a dëmtojnë pronën ose shërbimet e domosdoshme të ofruara nga palët e treta.

Në të shumtën e rasteve, ndërmjetësimi financiar në Shqipëri udhëhiqet nga bankat, dhe këto banka janë të ekspozuara ndaj ndryshimeve klimatike. Për këtë

arsye, rreziqet klimatike mund të dëmtojnë vlerën e aktiveve financiare dhe, në një skenar ekstrem, të ndikojnë aftësinë paguese të ndërmjetësve financiarë, të cilët janë mbajtësit e këtyre aktiveve. Nëse rreziqet që vijnë nga ndryshimet klimatike nuk adresohen mjaftueshëm, vendimet mbi dhënien e kredive dhe ato për investime mund të bazohen në informacione të paplota, duke bërë që kthimi i pritshëm i investimit i përshtatur për rrezikun, të jetë i njëanshëm. Për këtë arsye, bankave do t'u kërkohet, në mënyrë progresive, të vlerësojnë, matin dhe administrojnë si duhet rreziqet e tyre klimatike, veçanërisht mënyrën se si integrohen rreziqet e klimës në kuadrin e administrimit të rrezikut të kredisë së bankës.

Matja e rreziqeve financiare klimatike (si fizike ashtu edhe tranzitore) duhet të mbështetet nga të dhëna të besueshme rreth ekspozimit të bankës ndaj rrezikut të kredisë, sidomos ndaj korporatave jofinanciare (përfshirë bizneset e vogla dhe të mesme) dhe familjeve. Aktualisht, të dhënat nuk janë plotësisht të disponueshme¹². Sidoqoftë, mund të bëhet një vlerësim paraprak i ekspozimit të sektorit bankar ndaj rreziqeve tranzitore që rrjedhin nga rreziqet klimatike, duke ndarë portofolin e kredisë bankare të kompanive jofinanciare sipas sektorit ekonomik; duke nxjerrë në pah ekspozimin aktual të sektorëve më të ndjeshëm ndaj rrezikut tranzitor. Sektorët më të prekur nga klima renditen duke përdorur klasifikimin katër shifror NACE (sistemi i klasifikimit standard të përdorur nga Bashkimi Evropian). Megjithatë ky klasifikim nuk është hartuar në mënyrë plotësisht të saktë për të mbuluar të gjithë sektorët më të prekur nga klima, dhe mund të mos jetë aq i hollësishëm sa synohet, ai përdoret gjerësisht nga autoritetet dhe tregjet për të matur ekspozimin e bankës ndaj rreziqeve të periudhës tranzitore klimatike.

Klasifikimi i aktiviteteve ekonomike që kanë ndikim mbi politikat klimatike bazohet në Battiston et al. (2017)¹³, ku njihen si Sektorët me Ndikim në Politikat Klimatike (CPRS)¹⁴, dhe përkufizohen si veprimtari ekonomike që mund të ndikohen pozitivisht apo negativisht (përfshirë edhe transformimin e tyre në aktive të zhvlerësuar para kohe) gjatë një periudhe tranzitore të paqartë, pra ato janë të vlefshme në vlerësimin e rrezikut tranzitor klimatik¹⁵. Duke përdorur klasifikimin katër shifror NACE dhe duke transformuar ekspozimin ndaj sektorëve NACE në ekspozime ndaj CPRS, janë gjashtë sektorë që përcaktohen si sektorë me ndikim klimatik: (i) lëndë djegëse fosile; (ii) uji, energjia elektrike dhe gazi; (iii) përdorim intensiv të energjisë; (iv) ndërtimi;

¹² Për Shqipërinë përdoret një alternativë klasifikuese e ndryshme, sepse ajo nuk ka një Taksonomi të Gjellbër vetjake që përkufizon sektorët përkatës. Ky klasifikim përdoret edhe nga autoritetet tjera (si BQE dhe Banka e Austrisë) dhe akademikët.

¹³ Battiston, S., A. Mandel, I. Monasterolo, F. Schütze dhe G. Visentin. 2017. A climate stress-test of the EU financial system. In: *Nature Climate Change* 7. 283–88.

¹⁴ Climate Policy Relevant Sector.

¹⁵ Ky klasifikim përdoret për rastin e Shqipërisë sepse ajo nuk ka përpiluar Taksonominë e Gjellbër të saj, e cila përkufizon sektorët përkatës, dhe ky klasifikim përdoret gjerësisht nga autoritetet dhe akademikët.

(v) transporti; dhe (vi) bujqësia¹⁶. Këta sektorë me nënndarjet e mëtejshme të tyre arrijnë një total prej rreth 100 grupesh nga klasifikimi NACE, lidhur me llojet kryesore të teknologjive të ndryshme me ndikim në tranzicionin klimatik. Klasifikimi i sektorëve tregohet në Tabelën 3.

Tabelë 3: Klasifikimi i sektorit sipas NACE


CPRS	Roli i serave Emetimi i gazeve	Risku tranzitor	NACE (kod katërshifror)
Karburantet	Prodhimi i energjisë parësore nga karburantet; faktorë jo të drejtpërdrejtë për çlirimin e gazeve serë nga djegia e karburanteve	Të ardhurat kryesisht nga karburantet (p.sh.: nxjerrja, rafinimi); alternimi/përdorimi i burimeve të ndryshme i pamundur	Nxjerra e qymyrit, gazit dhe naftës (p.sh. 05.20), industria përpunuese lidhur me rafinimin e qymyrit, gazit dhe naftës (p.sh. 19.10) elektriciteti dhe gazi (p.sh. 35.21), shitjet me pakicë të automjeteve me karburant (p.sh. 47.30)
Energjia dhe Uji	Prodhimi i energjisë dytësore; faktorë në çlirimin e gazeve serë sipas karburantit të përdorur	Të ardhurat nga gjenerimi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike; alternimi i mundur (p.sh. energjia nga dielli, era)	Prodhimi elektrik (p.sh. 35.11)
Me energji intensive	Veprimtari më përdorim intensiv të energjisë	Ndikuar nga ndryshimet e çmimit të energjisë ose kufizimet në përdorimin e burimeve me intensitet të lartë gazesh serë	Industria nxjerrëse (p.sh. 07.10), sektorë të ndryshëm të industrisë përpunuese (p.sh. 11.01, 13.10, 23.51) bazuar në listën e rrjedhjes karbonike përpiluar nga BE
Transporti	Ofrimi dhe mbështetja e shërbimeve të transportit	Intensiteti i lartë në përdorimin e karburanteve, por jo të varur plotësisht në çlirimin e gazeve serë; ka mundësi për alternim	Fabrikimi i mjeteve motorike, anijeve dhe trenave (p.sh. 29.10), ndërtimi i rrugëve (p.sh. 42.11), shitja e mjeteve (p.sh. 45.32), transporti (p.sh. 49.10)
Ndërtimi	Ofrimi i shërbimeve të ndërtimit nga ngritja e objekteve të lëshimi me qira	Intensiteti i lartë në përdorimin e energjisë, por ka mundësi për alternim	Ndërtesa për banim ose për biznes (p.sh. 41.10), strehimi (p.sh. 55.10), prona të patundshme (p.sh. 68.20)
Bujqësia	Bujqësi, pyjtaria dhe shërbimet përkatëse	Intensiteti i lartë në përdorimin e energjisë, por ka mundësi për alternim	Bujqësi, pyjtaria dhe peshkim (p.sh. 1.10)

Burimi: <https://www.oenb.at/en/Publications/Financial-Market/Financial-Stability-Report.html>

Pesha e sektorëve CPRS dhe sektorëve të tjerë në ekspozimin total të bankave në Shqipëri në vitet e fundit, sipas kësaj metodologjie, tregohet në Figurën 5.

¹⁶ Për shkak të gatishmërisë së të dhënave, analiza është bazuar në të dhëna NACE niveli 1.

Figurë 5. Pesha e sektorëve CPRS dhe sektorëve të tjerë në ekspozimin total të bankave në Shqipëri në vitet e fundit, 2016-2022¹⁷




Më pak se gjysma e ekspozimit total të bankave në Shqipëri i atribuohet sektorëve me ndikim në politikat klimatike. Pesha e CPRS-së në ekspozimin e bankave, në pesë vitet e fundit, është lehtësisht nën 47%, dhe rreth 53% ndaj sektorëve të tjerë. Kjo ka mbetur relativisht e pandryshuar në pesë vitet e fundit. Gjithsesi, kjo është një shenjë e mirë për sektorin bankar, që pesha e CPRS-së nuk është dominuese krahasuar me sektorët e tjerë që nuk kanë ende ndikim mbi politikat klimatike. Sipas të dhënave të analizuara, nuk është e mundur të përcaktohet shkalla e rreziqeve, por vetëm ekspozimi ndaj tyre.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj secilit prej gjashtë CPRS-ve përkatëse (dhe "CPRS-ve të tjera" të përbëra nga sektorët e nxjerrjes dhe përpunimit) për rrezikun tranzitor tregohet në Figurën 6. Ajo evidenton që pesha në secilin sektor ka mbetur relativisht e njëtrajtshme përgjatë periudhës së vëzhguar.

¹⁷ Disa shënime për vlefshmërinë e të dhënave:

- Sektori B (Industria nxjerrëse) dhe C (Industria përpunuese) përmbajnë klasa që i përkasin një CPRS-je tjetër dhe një pakicë e tyre i përkasin sektorëve të tjerë, që nuk janë CPRS. Për ta adresuar këtë çështje, është krijuar një sektori i ri me ndikim në politikat klimatike (CPRS-të e tjera).
- Sektorët D-I përfshijnë më shumë se një CPRS, por prania e sektorëve të tjerë është e papërfillshme dhe, rrjedhimisht, paramenduar që të gjitha klasat i përkasin sektorit dominues.

Figurë 6. Nënndarja e ekspozimit të bankave ndaj sektorëve me ndikim në politikat klimatike për periudhën 2016-2022



Burimi: Llogaritje të brendshme bazuar në të dhëna të datës 31.08.2022.

Spektori i vetëm me ekspozimin më të konsiderueshëm për bankat shqiptare ndaj rrezikut tranzitor është sektori i “Ndërtimit” që përfshin ndërtesa për banim dhe biznes, aktivitetet qiradhënëse dhe pronat e patundshme. Pësha në ekspozimin total është rreth 15-19%, me një trend rritës në kohë.

Ekspozimi i dytë më i madh është në agregimin e “CPRS-ve të tjera” (të cilat llogariten me përqindjen më të lartë në fillim të periudhës), që përfshijnë sektorët nxjerrës dhe përpunues. Kjo përfshin veprimtari që kërkojnë një sasi të lartë energjie, siç janë industria nxjerrëse dhe sektorët e tjerë të industrisë përpunuese, që përdorin një intensitet të lartë energjie bazuar në listën e BE-së për çlirim/ nxjerrjen e karbonit. Pësha për këtë sektor është ndërmjet 14-19%, me një trend zbritës përgjatë periudhës së analizuar.

Ekspozimi i “Bujqësisë”, që konsiderohet të jetë tepër i ndjeshëm ndaj klimës, është nën 2% dhe i qëndrueshëm në periudhën kohore të vrojtuar. Një arsye tjetër për këtë ekspozim të ulët, mund të jetë fakti që punonjësit e bujqësisë e financojnë prodhimin e tyre nga burime të tjera (të tyre), në vend të bankave. Sektori i bujqësisë mbart një nivel shumë herë më të lartë të rrezikut fizik në krahasim me rrezikun tranzitor.

Një tjetër sektor me ndjeshmëri të lartë ndaj klimës, sektori i “Transportit,” është rreth 2-3% dhe i qëndrueshëm në periudhën kohore të vrojtuar. Ky sektor përfshin fabrikimin e mjeteve të transportit, ndërtimin e rrugëve, shitjen e automjeteve

dhe shërbimet e transportit. Ky sektor ekspozohet, nga ana materiale, ndaj rrezikut tranzitor, si pasojë e prezantimit të rregulloreve të reja, që kanë për qëllim përmirësimin e efektivitetit energjetik të automjeteve, çmimeve të larta të karburanteve nga taksat karbonike, ose e rregulloreve të tjera mjedisore, që mund të rrisin kostot e prodhimit dhe mirëmbajtjes. Kërkesa për disa shërbime ose produkte të caktuara mund të bjerë. Përdorimi në rritje i mjeteve elektrike dhe vendosja e taksave karbonike, do t'i vërë këto aktivitete përballë rreziqeve të larta.

5.2.1. EKSPOZIMI I SEKTORIT BANKAR NDAJ RREZIQEVE FIZIKE

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut fizik nuk duhet lënë pas dore, sepse mund t'i shkaktojë këtij sektori humbje të larta. Shqipëria është e rrezikuar nga fatkeqësitë natyrore. Në dhjetë vitet e ardhshme, pritet që, të paktën njëherë, të ndodhin përmbytje që shkaktojnë dëme të mëdha dhe vënë në rrezik jetën në zonat urbane dhe/ose bregdetare¹⁸. Shirat e rrëmbyeshme stinore dhe përmbytjet pasuese kanë prekur Shqipërinë në tre dekadat e shkuara. Midis viteve 1980 deri në vitin 2010, 9 përmbytje dhe 2 stuhi kanë dëmtuar më shumë se 600 mijë njerëz dhe kanë shkaktuar dëme ekonomike në shumën mbi 24 milion dollarë. Gjithashtu, shirat intensive të shkaktuara nga stuhitë e fuqishme, së bashku me praktika të gabuara të punimit të tokës dhe shpyllëzimin në rritje, mund të çojnë në përmbytje të konsiderueshme, duke shkaktuar dëme të mëdha në të gjithë vendin¹⁹.

Shirat e rrëmbyeshme mund të shkaktojnë rrëshqitje të tokës (klasifikuar të larta në Shqipëri) dhe përmbytje të zonave të mëdha bujqësore, banesave dhe ndërtesave industriale, si dhe të shkaktojnë të tjera ndryshime në mjedis. Ndryshimet klimatike kanë gjasa t'a shndërrojnë pjerrësinë dhe qëndrueshmërinë e nënshtresës shkëmbore, si pasojë e ndryshimeve të reshjeve dhe/ose temperaturës.

Mungesa e ujit klasifikohet me rrezik të mesëm, që nënkupton se, në 10 vitet e ardhshme, ka 20% gjasa që të ndodhin thatësira²⁰. Rreziqet nga i nxehti ekstrem klasifikohen të nivelit të mesëm, që do të thotë se, në pesë vitet e ardhshme, ekziston më shumë se 25% mundësi që të ketë të paktën një periudhë ekspozimi ndaj nxehtësisë së tejskajshme, që shkakton trysni të të nxehtit.

Rreziku i zjarreve pyjore klasifikohet me probabilitet të lartë, ku mundësia që kushtet meteorologjike të bëhen faktor i zjarreve masive pyjore është më shumë se 50%, çfarë ka gjasa të shkaktojë humbje jete dhe prone në çfarëdolloj viti. Rreziku nuk vjen vetëm nga flakët e drejtpërdrejta dhe ekspozimi rrezatues, por edhe nga stuhitë e hirit dhe zjarret në sipërfaqe të ulëta. Kur ka ngjarje klimatike me zjarre ekstreme, erërat e forta dhe mbeturinat e mbartura nga erëra mund të dëmtojnë integritetin e infrastrukturës. Rritja e parashikuar e temperaturës dhe një

¹⁸ <https://thinkhazard.org/en/report/3-albania/FL>


¹⁹ <https://climateknowledgeportal.worldbank.org/country/albania/vulnerability>

²⁰ <https://thinkhazard.org/en/report/3-albania/DG>

shpërndarje më e çrregullt e reshjeve nënkupton që stina e zjarreve do vazhdojë më gjatë dhe do të ketë më shumë ditë ku klima nxit përhapjen e zjarrit sepse, gjatë stinëve me zjarr, do të zgjaten periudhat me mungesë shiu. Edhe ashpërsia e zjarreve mund të përkeqësohet. Së fundmi, rënia e tërmeteve klasifikohet me rrezik të mesëm, që nënkupton se, në 50 vitet në vijim, mundësia për një tërmet shkatërrues është 10%.

Rreziqet kryesore të përshkruara më lart nuk kanë të njëjtën shkallë rëndësie dhe intensiteti në të gjithë vendin. Vetëm zjarret pyjore llogariten me probabilitet të lartë në të gjithë vendin, ndërsa ashpërsia dhe probabiliteti i rreziqeve të tjera janë të ndryshme. Për vlerësimin e ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve kërkohet analiza e shpërndarjes gjeografike të huave, sepse ajo përshkuan sasinë e huave në zona të caktuara me ekspozim më të lartë ndaj rrezikut. Për shembull, një bankë me një ekspozim të lartë ndaj huave të dhëna fermerëve, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në zona me probabilitet të lartë përmbajtjes, ose përpunuesve të drurit të zonave me rrezik të lartë zjarresh pyjore, duhet t'a shqyrtojë ekspozimin dhe të vlerësojë efektet mbi rrezikun e tyre të kredisë. Një tjetër shembull është analiza e portofolit të kredive të shtëpive në zonat që kanë rrezik rrëshqitje dhe ose përmbajtjeje, teksa këto ngjarje mundet, nga njëra anë, të dëmtojnë objektet, por edhe të ulin çmimin e pronave të paluajtshme dhe, rrjedhimisht, vlerën e kolateralit, gjë që mund të ketë një ndikim domethënës në rrezikun e kredisë së bankave, nëse nuk përlogaritet si duhet. Në përfundim, rreziqet e degëve bankare në zonat me rrezik të lartë shkatërrimesh natyrore, shkaktojnë ndërprerjen e veprimtarisë dhe rrisin rrezikun operacional, nëse banka nuk merr masat e domosdoshme përgatitore dhe zbutëse. Tetë rreziqet kryesore që kanë rëndësi për Shqipërinë tregohen në Figurën 7.

Figurë 7. Përmbledhja e rreziqeve kryesore dhe ashpërsisë së tyre




Burimi: Think Hazard.

Figura 7 tregon që rreziqe të tilla si zjarret pyjore dhe rrëshqitjet e dheut (përveç dy rajoneve²¹) kanë gjasa të ndodhin në mënyrë të barabartë në të gjithë vendin. Ndërsa gjashtë rreziqet e tjera kanë shpërndarje të ndryshme, edhe analiza e tyre është e rëndësishme sepse ofron diferencimin mes rajoneve që mund të kërkojnë veprime të tjera nga bankat.

Efektet më të drejtpërdrejta të rrezikut fizik ndaj bankave vijnë përmes efekteve të menjëhershme të rrezikut në rrjetet e degëve bankare dhe, rrjedhimisht, ndikojnë në rrezikun operacional të bankës, si edhe përmes ekspozimit të portofolit të kredisë së bankës ndaj këtyre rreziqeve, duke sjellë rritje të rrezikut të kredisë. Këtu, shembulli më i thjeshtë është madhësia e portofolit të kredive të banesave, në zonat ku rreziku i ngjarjeve me pasoja të rënda është i lartë. Të dhënat aktuale të disponueshme rreth rreziqeve kryesore dhe ashpërsisë së tyre, paraqesin një ide të përgjithshme për rreziqet fizike, teksa harta e rreziqeve nuk është mjaftueshëm e detajuar.

Në fund të vitit 2021, ekzistonin 421 degë bankare në Shqipëri, ku gati gjysma e tyre (43.0%) ishin në rajonin e Tiranës. Figura 8 paraqet një shpërndarje rajonale të shtrirjeve të degëve në vend. Duke marrë në konsideratë të gjitha rreziqet dhe nivelin aktual të detajimit, ekspozimet e bregut perëndimor mbartin nivelin më të lartë të rrezikut fizik.

Figura 8. Shpërndarja e degëve sipas rajonit




Burimi: Llogaritje të brendshme.

Për portofolin e huave të personave fizikë, portofoli i pronave të paluajtshme mund të jetë drejtpërdrejtë i ekspozuar ndaj rreziqeve fizike, të cilat mund të ndikojnë vlerën e pronave. Në qershor 2022, 66.3% e totalit të portofolit të pronave të paluajtshme përbëhej nga portofoli me prona të patundshme, ndërkohë pjesa

²¹ Rrëshqitjet e dheut në rajonet e Hasit dhe Lushnjës mbartin rrezik të mesëm.

tjetër e portofolit përbëhet nga kredia konsumatore dhe kredi të tjera. Po t'a ndajmë 66.3% e portofolit të pronave të paluajtshme, 46.7%²² ose pesha më e lartë e huave, është dhënë në rajonin e Tiranës, ndërsa ekspozimi i dytë më i lartë është në rajonin e Durrësit, me 4.5%. Nga kjo analizë mund të arrihet në përfundim se rajoni i Tiranës ka ekspozimin më të lartë deri më tani. Prandaj është e rëndësishme që ky rajon të analizohet në mënyrë më të hollësishme për të matur rrezikun fizik real. Analiza e ekspozimeve individuale të bankave është me rëndësi për të vlerësuar nëse shpërndarja është mesatarisht e vlefshme për të gjitha bankat, apo nëse ka banka që janë më të pranishme në rajone të caktuara dhe si pasojë janë më të ekspozuara ndaj rreziqeve specifike.

Figurë 9. Peshë e huave sipas shtëpive në totalin e huave të familjeve sipas rajonit akorduar personave fizikë²³



Burimi: Llogaritje të brendshme bazuar në të dhëna të datës 30.6.2022

5.3. DISKUTIMI I REZULTATEVE TË PYETËSORIT NË SEKTORIN BANKAR

Dymbëdhjetë banka në Shqipëri morën pjesë në PyetëSORIN për Rreziqet Klimatike dhe Mjedisore shpërndarë në muajin gusht 2022. Analiza evidentoi se praktikat dhe përparimi në administrimin e rreziqeve klimatike tek të gjitha bankat pjesëmarrëse, ishte mjaft i ndryshëm. Në përgjithësi, pyetëSORI tregoi se sektori bankar është ende duke hedhur hapat fillestarë në këtë fushë dhe në administrimin e këtyre rreziqeve. Gjetjet e PyetëSORIT janë përmbledhur në Tabelën 4:

²² Mbi portofolin total të pronave të paluajtshme.

²³ Përqindja llogaritur me portofolin total të pronave të paluajtshme.

Tabelë 4: Përfundimet kryesore nga Pyetësi për CRER²⁴ në sektorin bankar

#	Përfundime
1	Bankat kanë përparuar me ritëm të ndryshëm në administrimin e rreziqeve klimatike.
2	Bankat me kapital të huaj, sidomos ato që janë pjesë e grupeve bankare të Bashkimit Evropian, përfitojnë nga ekspertiza e grupit përmes zbatimit të politikave korporatë e grupit dhe transferimit të njohurive.
3	Disa banka po përparojnë drejt zhvillimit të produkteve të gjelbra, si për korporatat ashtu edhe për individët. Rëndom, këto hua të gjelbra ofrohen për të përmirësuar efektivitetin e energjisë së ndërtesave.
4	Asnjë bankë nuk ka integruar rreziqet klimatike në pasqyrën e tyre të rrezikut. Në përgjithësi, bankat përpilojnë "listat përjashtuese", duke renditur aktivitetet ekonomike (ose klientët) që konsiderohen të papërputhshëm me vlerat e bankës, dhe, rrjedhimisht nuk tregojnë vullnet financues ndaj tyre.
5	Një e treta e bankave i kanë ndarë tashmë rolet dhe përgjegjësitë për qëndrueshmërinë dhe, më konkretisht, për administrimin e rreziqeve klimatike (në disa raste kryhen nga një administrator i pavarur, në raste të tjera nga drejtuesi ekzekutiv i bankës, dhe vetëm në një rast nga zëvendësdrejtuesi ekzekutiv). Megjithatë, praktikat janë ende në fazën fillestare. Një e treta e bankave tashmë zbatojnë praktikën e raportimit të bordi mbikëqyrës dhe administruerit të rreziqeve klimatike (me një shpeshësi me bazë vjetore (1 rast), me bazë tremujore (2 raste), madje edhe mujore (1 rast)).
6	Një pakicë bankash (2 nga 12) kanë përfshirë, në mënyrë aktive, në funksionin e administrimit të rrezikut, vlerësimin e rreziqeve klimatike. Dy nga 12 banka i kanë përfshirë edhe në funksionet e njësisë për auditimin e brendshëm, përfshirë rreziqet klimatike, në planin e tyre vjetor. Asnjë bankë nuk ka raportuar përfshirjen e njësisë të përputhshmërisë me çështjet e qëndrueshmërisë.
7	Disa banka kanë filluar tashmë të integrojnë qëndrueshmërinë në vendimet e tyre për riskun e kredive të lëshuara. Këto banka përdorin, përgjithësisht, treguesit cilësorë të metodologjisë së klasifikimit të riskut, për të vlerësuar aftësinë e tyre pagues përpara se të lëshojnë hua. Shumica e bankave nuk janë ende të gatshme të përfshijnë rreziqet klimatike në kornizën e administrimit të rrezikut të kredisë. Kriteri i zbatuar më gjerësisht ndër ato të fundit ka të bëjë me pranimin ose mohimin e dhënies së kredive në sektorin ekonomik ku vepron kredimarrësi.
8	Asnjë bankë nuk zotëron një proces për grumbullimin sistematik të të dhënave të klientit për të vlerësuar gjurmën e tyre karbonike (pra, çlirimi i gazeve serë, planet e harmonizimit me NDC-të e Shqipërisë/Marrëveshjen e Parisit etj.), dhe bankat nuk po sigurojnë të dhëna nga burime të jashtme (vetëm një bankë ka grumbulluar të dhëna jo të standardizuara).
9	Shumica e bankave kanë bërë hapa para në integrimin e rreziqeve klimatike në kornizën e administrimit të rrezikut operacional. Në hartimin e planeve të vazhdueshmërisë së aktivitetit po merren në konsideratë rreziqet fizike më të rëndësishme përmes të dhënave nga shoqëritë e sigurimit (të dhënat nuk janë të lidhura përkatësisht me rreziqet klimatike dhe mjedisore, por ato janë siguruar për zjarre, përmbytje dhe tërmete, ndër të tjera).
10	Asnjë bankë nuk ka bërë përparime të qenësishme në integrimin e rreziqeve klimatike në rrezikun e tregut dhe atë të likuiditetit.
11	Bankat shqiptare nuk kanë lëshuar në treg bono të gjelbra, dhe vetëm një prej tyre po planifikon t'a bëjë këtë në periudhën afatshkurtër ose afatmesme.

5.4. SFIDAT PËR BANKËN E SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë, në mënyrë të ngjashme me bankat e tjera qendrore në botë, ka filluar t'i thellojë njohuritë rreth këtyre rreziqeve. Sidoqoftë, mjetet dhe metodologjitë për matjet e rrezikut klimatik janë ende në fazë fillestare dhe paraqiten një sërë sfidash analitike. Aktualisht nuk ka ende një sistem klasifikimi unifikues (taksonomi) për aktivitetet e biznesit, prandaj bashkëpunimi me

²⁴ CRER: *Climate-related and Environmental Risks*

qeverinë merr një rëndësi të veçantë për të zhvilluar dhe zbatuar një Taksonomi Kombëtare të Gjellbër, bazuar në Taksonominë e BE-së, ndërsa jemi në procesin e integritimit. Si bankë qendrore, hapi i parë në trajtimin e rreziqeve klimatike është identifikimi dhe adresimi i tyre. Kjo detyrë paraqet një sfidë për ne: shumë prej metrikëve (sidomos objektivi 3 më poshtë) mbi të cilat mbështetemi zakonisht për të vlerësuar ekspozimin e institucioneve financiare, nuk marrin në konsideratë rrezikun financiar klimatik, sepse cilësimet e tyre kërkojnë përdorimin e një baze të dhënash dhe teknikash vlerësuese të reja. Disa shembuj:

- metrika e ekspozimit ndaj rrezikut të përmbytjeve. Pesha e ekspozimit të huave të bankave shqiptare ndaj kompanive që ndodhen në zona me rrezik përmbytjesh në raport me huatë totale, mund të shërbejë si një metrikë e ekspozimit ndaj rrezikut të përmbytjeve;
- intensiteti karbonik i kredive, që llogarit intensitetin e përgjithshëm të çlirimit të karbonit në huatë e dhëna nga bankat/ raporti midis çlirimit të karbonit dhe huave për çdo sektor; etj.

Në këtë kontekst, mbikëqyrësit duhet të fitojnë përvojë dhe njohuri rreth këtyre metrikëve e metodologjive të reja, në mënyrë që të jenë të aftë të ndërmarrin vendime të mirinformuara në lidhje me politikat përkatëse të ndjekura. Dhe këtu paraqitet sfida e dytë me të cilën përballlemi: Rritja e kapaciteteve dhe e ndërgjegjshmërisë. Përparësia e bankave qendrore është të rrisë kapacitetet për të analizuar dhe studiuar më tej provat empirike të pasojave financiare të rreziqeve klimatike.

Vlerësimi i rreziqeve klimatike të sektorit financiar është i ndërlikuar prej faktit se institucionet financiare nuk janë mjaftueshëm të përgatitura për të administruar rrezikun klimatik dhe, shpeshherë, dështojnë në raportimin e të dhënave të dobishme rreth këtyre rreziqeve.

Të dhënat klimatike aktualisht mungojnë jo vetëm për mbikëqyrësit, por edhe për institucionet financiare, për shkak të mungesës së deklarimit nga klientët e tyre. Kjo e ndërlikon vlerësimin e rrezikut klimatik si nga institucionet financiare ashtu edhe nga mbikëqyrësit. Prandaj interesi ynë është të mbështesim institucionet financiare kur ato angazhohen me klientët e tyre dhe palët e tjera në ngritjen e një infrastrukture të dhënash që nevojitet për të matur rrezikun klimatik.

Modelet makroekonomike: Mes modeleve klimatike dhe makro-ekonometrike të bankës qendrore ekziston një mospërputhshmëri. Për të llogaritur më mirë rrezikun klimatik, modelet makroekonomike duhet të përballen me një sërë burimesh që paraqesin asimetri ose heterogjenitet, sipas sektorit, rajonit, vendit e llojit të individit dhe përfshijnë një proces real të formimit të pritshmërive. Ngritja e urave lidhëse për të plotësuar mangësitë metodologjike dhe hendeqet e të dhënave është parakusht thelbësor për veprimin dhe përfundimet në frontin prudencial ose monetar. Rrjedhimisht, kjo strategji ka rëndësi për transformimin e suksesshëm drejt financave të qëndrueshme.

6. PLAN VEPRIMI: PLANI STRATEGJIK I GJELBËR (2023-2025)

Udhërrëfytyesi për Financat e Gjelbra është krijuar në bashkëpunim me Bankën Botërore (FinSAC). Ai bazohet në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe është në përputhje me Planin e Veprimit të Komisionit të BE-së. Udhërrëfytyesi përshkruan planin e veprimit në Bankën e Shqipërisë për tri vitet e ardhshme mbi financimin e gjelbër.

Duke qenë se rreziqet klimatike transmetohen në rreziqe financiare, roli i Bankës së Shqipërisë në identifikimin, monitorimin dhe administrimin e tyre është shumë planesh. Prandaj, plani i veprimit përfshin një sërë aktiviteteve që do të ndërmerren nga departamente të ndryshme brenda Bankës së Shqipërisë, në varësi të mandatit dhe urgjencës së tyre për të vepruar.

6.1. VIZIONI

Sistem bankar i qëndrueshëm, elastik dhe i shëndetshëm

6.2. OBJEKTIVAT

- Rritja e ndërgjegjësimit ndaj rreziqeve klimatike në Bankën e Shqipërisë dhe forcimi i burimeve njerëzore për t'u angazhuar në analizën e ndryshimeve klimatike.
- Qasje graduale dhe përsëritëse, e mbështetur nga njohuritë teknike të BSH-së, në përputhje me punën e organizatave evropiane dhe ndërkombëtare dhe nëpërmjet angazhimit të vazhdueshëm me organizatat kombëtare/rajonale/ndërkombëtare.
- Edukimi i publikut dhe i institucioneve lidhur me këtë strategji.
- Rritja e ndërgjegjësimit për rreziqet klimatike, si brenda stafit të bankës qendrore, ashtu edhe ndërmjet institucioneve financiare dhe aktorëve ekonomikë.
- Roli edukativ i sektorit bankar në marrjen e vendimeve financiare të mirinformuara duke marrë parasysh rreziqet, ndikimet dhe mundësitë e qëndrueshmërisë.

6.3. QËLLIMET

Qëllimi 1. Inventarizimi: Ndërtimi i burimeve dhe njohurive – Puna për të kuptuar, monitoruar dhe administruar më mirë ndikimet ekonomike dhe financiare të ndryshimeve klimatike dhe tranzitore në ekonomi dhe në sektorin financiar.

- Qëllimi 1.1. Identifikimi i burimeve të të dhënave dhe boshllëqeve në rreziqet dhe mundësitë ekonomike dhe financiare të klimës dhe puna për të krijuar të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme.
- Qëllimi 1.2. Zhvillimi i metrikave/indikatoreve për monitorimin e vazhdueshëm të ekspozimeve të bankave ndaj rrezikut klimatik.
- Qëllimi 1.3. Kontakti me institucionet e tjera kombëtare të përfshira në politikat klimatike.
- Qëllimi 1.4. Analizimi i kanaleve përkatëse përmes të cilave ndryshimi klimatik dhe tranzitor mund të ndikojnë tek kompanitë dhe familjet shqiptare, si dhe tek institucionet financiare.
- Qëllimi 1.5. Hartimi i skenarëve tranzitorë që janë të rëndësishëm për Shqipërinë për vlerësimin e rrugës së mundshme tranzitore.
- Qëllimi 1.6. Angazhimi me institucionet financiare për të kuptuar më mirë praktikatat e tyre kur bëhet fjalë për administrimin e rrezikut klimatik dhe zhvillimin e zgjidhjeve të qëndrueshme financiare.
- Qëllimi 1.7. Harta e rrezikut dhe oportuniteteve nga ndryshimet klimatike për sektorin bankar si dhe vlerësimi i materializimit të tyre brenda institucioneve.
- Qëllimi 1.8. Rritja e kapacitetit të bankave për administrimin e rrezikut klimatik.

Qëllimi 2. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve përkatëse për financimin e qëndrueshëm.

- Qëllimi 2.1. Studime të përbashkëta në fushën e qëndrueshmërisë ndërmjet palëve të interesuara.
- Qëllimi 2.2. Rritja e bashkëpunimit me institucione të tjera ndërkombëtare.

Qëllimi 3. Nxitja e veprimit më të gjerë.

- Qëllimi 3.1. Përmirësimi i të kuptuarit të përgjithshëm të rreziqeve të lidhura me klimën dhe puna për përafrimin rregullator me legjislacionin e të BE-së (ACQUIS) për financim të qëndrueshëm.
- Qëllimi 3.2. Rritja e transparencës në temat që lidhen me klimën.


7. AKTIVITETET DHE KALENDARI I TYRE

Zhvillimi i këtyre aktiviteteve të kësaj strategjie synojnë të ndihmojnë në organizimin e punës institucionale dhe të qartësojnë rolet dhe përgjegjësitë. Aktivitetet dhe kalendari përkatës do të përditësohet rregullisht. Udhërrëfyesi shpjegon arsyetimin për përfshirjen e rrezikut klimatik në aktivitetet e Bankës së Shqipërisë, krijon struktura organizative të dedikuara me plane-pune për të nxitur mësimin dhe zhvillimin e analizës klimatike, harton udhëzime për bashkëpunimin ndërkombëtar, përcakton një agjendë politikash me afat kohor, për integrimin e dimensioneve klimatike në zbatimin e politikave, zhvillon parimet e komunikimit etj. Udhërrëfyesi është gjithëpërfshirës, dhe përcakton të gjitha përgjegjësitë kryesore të BSH, të ndara në gjashtë kategori si më poshtë:

- Kultura/aktivitetet e Bankës së Shqipërisë
- Njohuri dhe Kërkim
- Vlerësimi dhe Matja e Rrezikut
- Politika monetare
- Angazhimi kombëtar dhe ndërkombëtar
- Mbikëqyrja dhe rregullimi

7.1. KULTURA / AKTIVITETET E BANKËS SË SHQIPËRISË

Figurë 10. Kultura / aktivitetet e Bankës së Shqipërisë



7.1.1. PËRKUFIZIMI I QEVERISJES SË BRENDSHME

Përfshirja e punës për ndryshimet klimatike në strukturat organizative të dedikuara, nëpërmjet krijimit të rrjeteve të brendshme për ndryshimet klimatike, të qendrave brenda institucionit, të forumeve vendase të ekspertëve ose të njëjësive të dedikuara. Banka e Shqipërisë do të vlerësojë dhe krahasojë praktikatat ekzistuese

për qeverisjen e qëndrueshmërisë në banka të tjera qendrore, duke përfshirë krijimin e mundshëm të komiteteve të gjelbra/qëndrueshmërisë ose qendrave të gjelbra të specializuara.

7.1.2. QËNDRIMI I BANKËS QENDRORE

Banka e Shqipërisë nëpërmjet kësaj strategjie dhe veprimtarisë së saj në këtë drejtim synon që të këtë rol udhëheqës në sektorin bankar nëpërmjet akteve juridike (siç është kjo strategji) dhe veprimtarisë së saj konkrete. Gjithashtu Banka e Shqipërisë do të mbajë komunikim të shpeshtë me publikun për ecurinë e këtyre aktiviteteve dhe impaktin e tyre. Ky qëndrim do të përfshijë disa rregulla sjelljeje të zbatueshme për të gjithë punonjësit e Bankës së Shqipërisë, si për shembull inkurajimi i ndryshimit të sjelljes së stafit të brendshëm drejt një mjedisi më të qëndrueshëm përmes trajnimit dhe shkëmbimit të informacionit.

7.1.3. STRATEGJIA DHE PLANI I KOMUNIKIMIT

Banka e Shqipërisë do të rrisë ndërgjegjësimin për rreziqet klimatike dhe ngritjen e kapaciteteve si brenda stafit të bankës qendrore, ashtu edhe subjekteve të varësisë apo atyre që licencon, nëpërmjet trajnimeve, konferencave, tryezave të rrumbullakëta dhe fushatave sensibilizuese të organizuara nga vetë BSH-ja. Një mjet tjetër i rëndësishëm për ndërgjegjësimin janë fjalimet publike të mbajtura nga administratorët e Bankës së Shqipërisë dhe raporti vjetor i bankës.

Gjithashtu Banka e Shqipërisë zhvillon veprimtari edukuese (leksione, seminare, orë të hapura), duke pasur për qëllim zhvillimin e kulturës së publikut. Kështu lidhja midis financës, ekonomisë reale dhe mënyra se si vlerësimet e rreziqeve klimatike integrohen me aktivitetet bankare, të sigurimeve, të investimeve dhe të modeleve të biznesit, mund të bëhen pjesë integrale e veprimtarive edukuese. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë do të zhvillojë, nxisë dhe përhapë praktikën më të mira në edukimin financiar në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm. Ndryshimet klimatike dhe rreziku që lidhet me to duhet të përqafohen nga vendimmarrësit, qytetarët dhe punëtorët, në jetën e tyre private dhe profesionale, çdo ditë.

Strategjia e komunikimit, e cila informon për rreziqet që ndryshimet klimatike dhe politikën tranzitore mund të ushtrojnë mbi ekonominë dhe sistemin financiar dhe si mund të ndikojë në projeksionet apo vendimet e politikës monetare, mund të jetë një mjet i fuqishëm, brenda mandatit të bankës qendrore, drejt zbatjes dhe përshtatje së ndryshimeve klimatike.

7.2. RITJA E KAPACITETEVE DHE KËRKIMI PËRKATËS SHKENCOR

Figurë 11. Aktivitetet lidhur me ngritjen e kapaciteteve



7.2.1. NGRITJA E KAPACITETEVE TË BSH-SË

Për të realizuar këtë strategji, është e një rëndësie vendimtare që të ndërtohen kapacitetet brenda bankës. Prandaj, faza e parë është ngritja e stafit të bankës qendrore – forcimi i kapaciteteve të saj modeluese dhe analitike, si dhe vlerësimi i rrezikut të klimës për institucionet financiare (d.m.th. ushtrime të provës së rezistencës, rregullimi, mbikëqyrja bankare etj.), dhe në fazën e dytë të ketë njohuri dhe burime njerëzore për zbatimin e politikave përkatëse. Kjo mund të bëhet pas vlerësimit të nevojave të brendshme dhe ekspertëve të përfshirë, duke marrë parasysh opsionet e disponueshme të trajnimit (d.m.th. trajnime në terren, online, etj.) të ofruara nga disa organizata ndërkombëtare.

Objekti është krijimi i burimeve dhe njohurive të nevojshme për fillimin e përgatitjes dhe zbatimit të përgjigjes së politikave të BSH-së për të trajtuar rrezikun e klimës dhe për të mbështetur ekonominë dhe sektorin financiar shqiptar në shfrytëzimin e mundësive përkatëse.


7.2.2. RAPORTI PERIODIK I QËNDRUESHMËRISË LIDHUR ME NDRYSHIMET KLIMATIKE

Si rezultat i punës që do të kryhet gjatë vitit në lidhje me këtë strategji, do të hartohet një raport periodik (vjetor) i cili do të përmbajë punime, diskutime, politika, hulumtime, etj.. Këto dokumente do të përmbajnë një përmbledhje gjithëpërfshirëse të çështjeve të lidhura me qëndrueshmërinë në kontekstin e Shqipërisë, por ato do të përfshijnë gjithashtu analiza të anketimit (si ai për ndërmarrjet), krijimin e indekseve ose matjeve përkatëse etj.. Në këtë raport vjetor, një rubrikë do t'i kushtohet raportit të progresit të zbatimit të kësaj Strategjie. Raporti periodik do të hartohet nga njësitë organizative të përfshira në hartimin e kësaj strategjie apo dhe nga njësi të tjera sipas vendimmarrjes së institucionit dhe do të koordinohet nga Departamenti i Kërkimeve.

7.3. VLERËSIMI DHE MATJA E RREZIKUT

Kontribuesi kryesor për vlerësimin dhe matjen e rrezikut do të jetë Departamenti i Stabilitetit Financiar. Në figurën 12 pasqyrohen aktivitetet përkatëse dhe shtrirja kohore e tyre.

Figurë 12. Aktivitetet e vlerësimit dhe matjes së rrezikut



7.3.1. PËRGATITJA E NJË PANELI²⁵ TË GJELBËR

Siç është diskutuar gjerësisht në këtë Strategji, Banka e Shqipërisë do të përcaktojë një sërë treguesish që lidhen me qëndrueshmërinë, të cilët mund të përdoren për monitorimin e ndikimit të saj në stabilitetin financiar. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë do të shqyrtojë praktikën e bankave të tjera qendrore dhe do të fokusohet veçanërisht në Panelin e Gjelbër të NGFS-së, i cili tashmë është zbatuar nga disa institucione homologe. Paneli i Gjelbër, pasi përcaktohet/zbatohet, do të shërbejë për ndjekjen e objektivave të stabilitetit financiar, por edhe për zbatimin e politikës monetare.

Për të përgatitur Panelin e Gjelbër, çelësi është përcaktimi i grupit të treguesve për të identifikuar nevojat për të dhëna. Pasi këto të përcaktohen, Banka e Shqipërisë duhet të jetë në gjendje të identifikojë mangësitë e të dhënave dhe të hartojë mjete dhe mekanizma për trajtimin e këtyre mangësive (d.m.th. vrojtime, përafrime, kërkesa për të marrë informacion nga ndaj sistemit bankar etj.).

²⁵ Në anglisht: Dashboard

7.3.2. PËRGATITJA E NJË ANKETE PËR NDËRMARRJET MBI GJENDJEN E TREGUT TË GJELBËR

Një nga burimet e informacionit në lidhje me financat e gjelbra është një anketë për korporatat që do të prezantohet dhe do të kryhet rregullisht për të mbledhur informacion mbi praktikat e qëndrueshmërisë së korporatave të mëdha shqiptare dhe për të identifikuar përmirësimet e bëra me kalimin e kohës. Për më tepër, ajo do të përdoret për të plotësuar disa nga boshllëqet e të dhënave të identifikuara gjatë përgatitjes së Panelit të Gjelbër dhe analizës së ekspozimit të bankave. Ky sondazh mund të përgatitet si i pavarur, ose si pjesë e disa anketave të cilat tashmë zhvillohen me industrinë.

7.3.3. PËRGATITJA E NJË METODOLOGJIE PËR NJË VLERËSIM NGA LART-POSHTË TË RREZIQEVE TRANZITORE

Ushtrimi i provës së rezistencës nga lart-poshtë është një nga aktivitetet e ndërmarra nga bankat qendrore në përpjekjet e tyre për të vlerësuar dhe përcaktuar sasinë e ndikimit të rreziqeve të lidhura me klimën në sistemin financiar. Për shkak të specifikave të të dhënave dhe natyrës së këtyre rreziqeve në përgjithësi, është e nevojshme të rregullohen ushtrimet ekzistuese të provës së rezistencës nga lart-poshtë, në mënyrë që të përfshihen aspekte të lidhura me klimën. Pas ngritjes së kapaciteteve, analizës dhe mbledhjes së detajuar të të dhënave, hapi tjetër do të jetë përgatitja e një metodologjie për kryerjen ushtrimit të provës së rezistencës nga lart-poshtë. Banka e Shqipërisë do të zbatojë një qasje graduale, duke nënkuptuar vlerësimin e rreziqeve një nga një, duke filluar nga rreziku tranzitor.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, Departamenti i Stabilitetit Financiar do të përgatisë një metodologji për vlerësimin e rreziqeve tranzitore që do të përfshijë metodologjinë aktuale të provës së rezistencës, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë. Modelet ekzistuese në përdorim përfshijnë tashmë një numër elementesh të përdorura për provën e rezistencës klimatike dhe parashikohet që këto modele të përshtaten për të përfshirë në analizë aspektet përkatëse të klimës. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është përcaktimi i skenarëve dhe mekanizmave përkatës të transmetimit të rreziqeve tranzitore në sektorin financiar.

7.3.4. USHTRIMI I PROVËS SË REZISTENCËS (STRES TEST) – PROVA E REZISTENCËS NGA LART-POSHTË PËR RREZIQET TRANZITORE

Pas përgatitjes së një metodologjie të provës së rezistencës për vlerësimin e rreziqeve tranzitore, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024, Departamenti i Stabilitetit Financiar do të kryejë testin e parë nga lart-poshtë të provës së rezistencës për vlerësimin e rreziqeve tranzitore. Qëllimi kryesor i këtij ushtrimi është testimi i metodologjisë, identifikimi i fushave të mundshme për përmirësim dhe marrja e idesë së parë për ndikimin sasior të rrezikut tranzitor në sektorin bankar.

7.3.5. VLERËSIMI NË NJË MOMENT KOHOR TË ÇAKTUAR TË EKSPOZIMIT TË SEKTORIT BANKAR SHQIPTAR NDAJ RREZIQEVE FIZIKE DHE ATYRE TRANZITORE

Si hap i parë në përcaktimin sasiar të ekspozimit të sektorit bankar ndaj rreziqeve tranzitore dhe atyre fizike, Departamenti i Stabilitetit Financiar do të punojë për ngritjen e një kuadri për këtë lloj analize, duke identifikuar mekanizmat përkatës për vlerësimin e këtyre rreziqeve, duke përcaktuar skenarët e përshtatshëm dhe rreziqet materiale të aplikueshme për Shqipërinë, duke u bazuar në skenarë dhe rreziqe të njohur ndërkombëtarisht. Departamenti do të punojë për hartimin e të dhënave të nevojshme për këtë lloj analize, si dhe burimet ku këto të dhëna janë të disponueshme dhe në përcaktimin e përfruesve dhe treguesve përkatës, kur disa nga të dhënat nuk janë të disponueshme. Rezultati i këtij veprimi do të jetë një raport i ekspozimit të sektorit bankar ndaj rreziqeve të tranzicionit dhe atyre fizike, i cili do të bazohet në atë të paraqitur në këtë strategji, por më i detajuar dhe më i saktë. Ky veprim do të bazohet në Panelin e Gjelbër²⁶ dhe do të përdoret si bazë për stres testin nga lart-poshtë të planifikuar për vitet 2024 dhe 2025.

7.3.6. PËRGATITJA E NJË METODOLOGJIE PËR NJË VLERËSIM NGA LART-POSHTË TË RREZIQEVE FIZIKE

Duke përdorur të njëjtën qasje si në rastin e rreziqeve tranzitore dhe njohuritë e përvojën e fituar gjatë procesit të përgatitjes së metodologjisë për vlerësimin e rreziqeve tranzitore, gjysma e parë e vitit 2025 do t'i kushtohet përgatitjes së metodologjisë për vlerësimin e rreziqeve fizike. Vlerësimi i këtyre rreziqeve është më sfidues pasi kërkon informacion që zakonisht nuk mblidhet nga bankat qendrore. Ky është kryesisht informacion i detajuar për vendndodhjen gjeografike të kompanive ose sektorëve të caktuar, si dhe vlerësimin e llojeve të rreziqeve dhe madhësisë së tyre në zona të caktuara. Analiza e kryer gjatë vitit 2023 do të lejojë hartimin e të dhënave përkatëse dhe identifikimin e burimeve të tyre. Qëllimi kryesor i këtij veprimi do të jetë përcaktimi i mekanizmit përkatës të tranzicionit për rreziqet fizike dhe mënyra për të bërë pjesë këtë rrezik në kuadrin ekzistues të provës së rezistencës. Natyra e këtyre provave të rezistencës është shumë e ndryshme nga ajo e zakonshme, pasi merr në konsideratë horizontet afatgjata, prandaj ka shumë aspekte që janë të ndryshme në krahasim me vlerësimin e rrezikut tranzitor.

²⁶ Green Dashboard

7.3.7. PROVA E REZISTENCËS NGA LART-POSHTË PËR RREZIQET FIZIKE

Pasi të jetë vendosur metodologjia që do të ndiqet, gjysma e dytë e vitit 2025 do t'i kushtohet provës së parë të rezistencës të rrezikut fizik, i cili do të ndihmojë në ekzaminimin e metodologjisë dhe dhënien e rezultateve të para sasiore për efektet e rreziqeve fizike në sektorin bankar. Të gjitha aktivitetet që lidhen me analizën e ekspozimit dhe provës së rezistencës janë planifikuar të kryhen nga Departamenti i Stabilitetit Financiar, por sigurisht në koordinim me departamentet e tjera përkatëse, si Departamenti i Politikës Monetare.

7.4. ANALIZA MAKROEKONOMIKE DHE POLITIKA MONETARE

7.4.1. USHTRIMI I ANALIZËS SË SKENARIT


Në modelimin e politikës monetare, goditjet e tanishme dhe të ardhshme (ngjarje që kanë potencial të ndodhin) që ndikojnë në rritjen e PBB-së, inflacionin, kërkesën e huaj, kursin e këmbimit apo çdo variabël tjetër, janë pjesë e rregullt e skenarëve të rrezikut. Këto goditje ndryshojnë linjën e ardhshme të reagimit të politikës monetare të nxjerrë nga modeli në krahasim me skenarin bazë. Goditjet e lidhura me manifestimet e ndryshimeve klimatike, janë përfshirë në simulime të caktuara, megjithëse nuk janë identifikuar në mënyrë eksplicite si të tilla. Në të ardhmen, goditjet e lidhura me ndryshimet klimatike do të përfshihen në mënyrë më aktive në parashikimet e politikës monetare në baza të rregullta. Sigurisht, duke marrë parasysh shtrirjen afatmesme të politikës monetare (përfshirë modelimin), goditjet e përhershme që mund të ndikojnë në ekonomi në dekadat në vijim janë të paparashikueshme. Megjithatë, goditjet kronike që janë bërë shumë më të rregullta vitet e fundit, sigurisht që janë të arritshme. Kështu, skenarët e dedikuar mund të zbatohen në baza të rregullta të përcaktuara në mënyrë eksplicite si të lidhura me "ndryshimet klimatike".

Së fundi, përfshirja e politikës monetare në procesin e të kuptuarit të efekteve që shkaktojnë goditjet klimatike dhe mjedisore në ekonomi, do të ndihmojë në integrimin e tyre në kuadrin ekzistues të analizës së politikave, parashikimeve dhe vlerësimit të rrezikut.

Kjo analizë do të kryhet nga Departamenti i Politikës Monetare.

7.5. ANGAZHIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Figurë 13. Aktivitetet e angazhimit kombëtar dhe ndërkombëtar




Për të thelluar njohuritë për rreziqet klimatike dhe për të përshtatur praktikat më të mira ndërkombëtare dhe rajonale, është thelbësore të vazhdoen angazhimet në nivele të ndryshme:

- Angazhimi kombëtar: Njëpërmjet bashkëpunimit me ministritë përkatëse dhe institucione të tjera publike me përgjegjësi në tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët; dhe njëpërmjet organizimit të Konferencave për Klimën me sektorin bankar dhe institucione të tjera publike. Njëpërmjet këtij angazhimi në nivel kombëtar, Banka e Shqipërisë do të kontribuojë në arkitekturën financiare. Disa shembuj të mundshëm mund të jenë zhvillimi i klasifikimit, standardeve, taksonomive, treguesve, metrikës, tabelave dhe mjeteve.
- Angazhimi rajonal: Pjesëmarrja në forume rajonale (d.m.th. Iniciativa e Vjenës, WBG).
- Angazhimi evropian: (Marrëveshja e Gjelbër e BE-së dhe Deklarata e Sofjes).
- Angazhimi ndërkombëtar: Angazhim i vazhdueshëm brenda Rrjetit për Gjelbërimin e Sektorit Financiar, duke synuar një pjesëmarrje më aktive në rrjedhat e ndryshme të punës që ata kanë. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me SECO, Bankën Botërore etj. dhe vlerësimi i pjesëmarrjes në organizata të tjera ndërkombëtare (d.m.th. BIS, Rrjeti i Qëndrueshëm Bankar, COP etj.).

7.6. RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA BANKARE

Kontribuesi kryesor për aktivitetet e rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare është Departamenti i Mbikëqyrjes. Figura 14 më poshtë pasqyron të gjitha aktivitetet dhe shtrirjen e tyre kohore.

Figurë 14. Aktivitetet e rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare



Masat rregullatore në lidhje me çmimin efektiv të karbonit, energjinë e pastër, mobilizimin e industrisë për një ekonomi të pastër dhe qarkulluese, efikasitetin e energjisë në ndërtesa, një sistem ushqimor miqësor ndaj mjedisit ose ruajtjen e biodiversitetit, janë futur tashmë nga EBA dhe shumë autoritete mbikëqyrëse. Autoritetit Bankar Evropian (EBA) iu dhanë disa mandate për të vlerësuar se si rreziqet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) mund të përfshihen në tre shtyllat e mbikëqyrjes së kujdesshme.

Ndërsa bankat me kapital shqiptar duhet të zhvillojnë qasjen e tyre drejt zhvendosjes sipas zhvillimeve të fundit, bankat me kapital të huaj, veçanërisht nga Bashkimi Evropian, kanë miratuar tashmë disa masa dhe praktika të brendshme të zhvillimit drejt kryerjes së veprimtarisë në një shkallë më të gjelbër nën ombrellën e aksionareve dhe të bankave të tyre mëma, të cilat mbajnë një rol udhëheqës për proceset e përmendura.

Duke u mbështetur në vullnetin e mirë dhe përgjegjësinë për të ndikuar në përbalimin e ndryshimeve klimatike, duke qenë gjithashtu i ndërgjegjshëm për pasigurinë e rrugës përpara, ekipi mbikëqyrës po angazhohet në hapat fillestarë të projektuar posaçërisht si fazë e parë dhe të paraqitur më poshtë.

7.6.1. NGRITJA E KAPACITETEVE

Rreziqet e lidhura me klimën janë burime të rreziqeve financiare për institucionet financiare dhe mund të kërcënojnë stabilitetin financiar. Duke pasur një kuptim të qartë të burimeve të këtyre rreziqeve, mbikëqyrësit janë më të aftë të përqendrojnë përpjekjet e tyre dhe të konstatojnë nëse subjektet e mbikëqyrura po vlerësojnë dhe menaxhojnë ekspozimet e tyre në mënyrë të përshtatshme.

Si hap i parë, duhet konsideruar ngritja e kapaciteteve të mbikëqyrësve për rrezikun klimatik, si një fushë e rëndësishme që kërkon një fokus të veçantë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të Bankës së Shqipërisë. Kjo mund të bëhet përmes seminareve, trajnimeve nga organizatat ndërkombëtare ose përmes fitimit të përvojës mbikëqyrëse nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse.

Gjithashtu, duke qenë se juridiksione të ndryshme përjetojnë burime të ndryshme të rreziqeve të lidhura me klimën, është e rëndësishme që mbikëqyrësit të punojnë me subjektet të cilat mbikëqyrin për të përcaktuar se cilat burime të rreziqeve janë të rëndësishme dhe materializimin e tyre.

Nuk ka një kategorizim standard universal të rreziqeve klimatike. Këto janë rreziqe që rrjedhin nga ekspozimi i institucioneve financiare ndaj rreziqeve fizike ose tranzitore, të shkaktuara ose të lidhura me ndryshimet klimatike, për shembull, dëmtimet e shkaktuara nga ngjarjet ekstreme të motit ose rënia e vlerës së aktiveve në sektorët me intensitet karboni.

7.6.2. NXJERRJA E UDHËZUESIT ME PRITSHMËRI RREGULLATORE PËR RREZIKUN KLIMATIK

Departamenti i Mbikëqyrjes do të angazhohet në nxjerrjen e një udhëzuesi me pritshmëri rregullatore për rrezikun klimatik, me qëllim që të inkurajojë bankat të përfshijnë rreziqet klimatike në kuadrin e tyre të menaxhimit/administrimit të rrezikut. Ky udhëzues duhet të jetë i bazuar në parime dhe jo i detyrueshëm për bankat, dhe do të shërbejë si bazë për dialogun mbikëqyrës. Ai do të rrisë ndërgjegjësimin e bankave në lidhje me rrezikun klimatik dhe do të vendosë disa pritshmëri se si bankat duhet të integrojnë rreziqet klimatike në kuadrin e përgjithshëm të administrimit të rrezikut, nën kuadrin aktual të kujdesit. Në këtë proces do të konsiderohet edhe harmonizimi me iniciativat e BQE-së, duke marrë parasysh edhe praktikatat e vendeve të tjera.

Pritjet kryesore të mbikëqyrjes do të përfshijnë:

- Strategjia dhe modeli i biznesit: Inkurajimi i bankave që të marrin parasysh ndikimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të rreziqeve mjedisore në hartimin e strategjisë së ushtrimit të veprimtarisë së tyre.
- Procesi i qeverisjes dhe i oreksit ndaj rrezikut: Ofrimi i udhëzimeve për bankat si të integrojnë siç duhet rrezikun financiar të lidhur me klimën në administrimin

e rrezikut. Bankat duhet të marrin parasysh rreziqet mjedisore kur krijojnë një kornizë të administrimit të rrezikut, të përfshijnë rreziqet që lidhen me klimën në kornizat e oreksit ndaj rrezikut dhe të përcaktojnë qartë përgjegjësinë për administrimin e rrezikut lidhur me klimën në të gjitha nivelet, si pjesë e strukturës së tyre organizative.

- Procesi i administrimit të rrezikut: bankat duhet të përfshijnë rreziqet mjedisore në kuadrin e administrimit të rrezikut si nxitës të kategorive ekzistuese të rrezikut (p.sh. rreziku i kredisë) dhe të përcaktojnë dhe kuantifikojnë këto rreziqe.

Banka e Shqipërisë ka në plan të krijojë tryeza të rrumbullakta diskutimi me institucionet e licensuara në mënyrë që të diskutojë efektet dhe sfidat e munshme që lidhen me financat e gjelbra. Këto takime kanë për qëllim të rrisin ndërgjegjësimin tek institucionet financiare. Në anën tjetër, pritet të marrë çdo reagim në përvojat që hasen nga institucionet e vetme, sferat e ndikimit dhe identifikimin e metodave për të promovuar një kalim tërheqës dhe të arsyeshëm për të gjitha palët.

7.6.3. PËRGATITJA E MODELEVE TË RAPORTIMIT

Pritshmëritë mbikëqyrëse për adoptimin e shqetësimeve të rreziqeve klimatike në organizimin dhe proceset e brendshme të bankave do të kërkohet të raportohen në formate të paracaktuara. Një raportim i tillë do të bazohet në modele që do të hartohen me qëllim që të ketë një kuptim uniform të përgatitjes së bankave drejt kalimit në një qasje mjedisore më miqësore, si dhe drejt përmbushjes së pritshmërive mbikëqyrëse.

7.6.4. BANKAT PARAQESIN VETËVLERËSIM PËR PËRPTHJEN ME PRITSHMËRITË MBIKËQYRËSE NDAJ FINANCIVE TË GJELBRA

Pasi të jetë miratuar udhëzuesi me pritshmëri rregullatore për rrezikun klimatik dhe të ketë filluar dialogu me bankat, mbikëqyrësit do të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të vlerësuar përputhshmërinë e bankës me kërkesat. Secilës banke individualisht do t'i kërkohet të bëjë një vetëvlerësim të nivelit të saj përgatitor ndaj pritshmërive mbikëqyrëse. Vlerësimi do të përfundojë në një analizë të mangësive që do të strukturohet përmes modeleve të raportimit që do të përgatiten në përputhje me rrethanat. Vlerësimi i bankave do të përfshijë edhe prezantimin e angazhimit të tyre individual (planet e veprimeve) mbi hapat që do të ndërmarrin për të ngritur proceset e brendshme drejt një qasje miqësore me klimën.

7.6.5. PËRGATITJA E NJË METODOLOGJIE VLERËSIMI PËR MODELIN E RAPORTIMIT, RISHIKIMI I VETËVLERËSIMIT DHE IDENTIFIKIMI I ÇËSHTJEVE QË DUHEN TRAJTUAR

Raportet e vetëvlerësimit të bankës do të analizohen nga mbikëqyrësit. Vlerësimi do të bazohet në një metodologji që do të përgatitet për këtë qëllim. Metodologjia

do të ndihmojë në vlerësimin e nivelit të të kuptuarit dhe përgatitjes të çdo banke individualisht ndaj pritshmërive të financimit të gjelbër dhe rreziqeve klimatike. Ajo do të shërbejë gjithashtu për krijimin e një pasqyre të plotë të qasjes së sistemit bankar dhe do të mbështesë përcaktimin e veprimeve të ardhshme për adresimin e të gjithë sistemit në një bazë më të rregulluar.

7.6.6. NË PËRPUTHJE ME PRAKTIKAT MË TË MIRA NDËRKOMBËTARE

Rishpërndarja e financave në sektorë të ndjeshëm ndaj klimës kërkon rrugë të qarta nga autoritetet mbikëqyrëse. Duke iu përmbajtur qasjes së përgjithshme të Bankës së Shqipërisë për përmbushjen e mandatit të saj në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, veçanërisht institucionet financiare ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, si dhe direktivat e nxjerra nga Banka Qendrore Evropiane dhe Autoriteti Bankar Evropian, Banka e Shqipërisë do të ndjekë nga afër udhëzimet dhe dokumentet mbështetëse që do të hartohen në lidhje me përmirësimin e mjedisit. Dokumentet e hartuar nga Komiteti i Bazelit do të jenë gjithashtu të një rëndësie kryesore për t'u respektuar nga afër, duke qenë burimi kryesor i udhëzuesit për të gjitha autoritetet mbikëqyrëse. Dokumentet e pritshme udhëzuese do të shërbejnë si një bazë e mirë orientuese për të identifikuar ndryshimet e nevojshme që do të ndërmerren nga Banka e Shqipërisë.

7.6.7. BASHKËPUNIME NDËRKOMBËTARE

Departamenti i Mbikëqyrjes do të zgjerojë fushën e saj të bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritete homologe, me qëllim shkëmbimin e përvojave në ndërtimin e një mjedisi të shëndoshë për institucionet financiare, për të ndryshuar në mënyrë efektive veprimtarinë e tyre në një qasje më të gjelbër dhe miqësore me mjedisin në veprimtarinë e tyre. Domosdoshmëria për t'u përballur me rreziqet dhe për të zhvilluar praktika organizative dhe të administrimit të rrezikut nga institucionet financiare, do të ishte më mirë të akordohej nën një orientim të qartë mbikëqyrës dhe rrugë rregullatore. Megjithatë, nisja e diskutimeve dhe përfshirja në konventa ndërkombëtare, do t'i sigurojë mbikëqyrjes njohuritë e domosdoshme për rindërtimin e kuadrit financiar të brendshëm me një qasje të përshtatshme për kalimin në një ekonomi më të gjelbër.

7.6.8. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDASE

Një kuadër i shëndoshë mbikëqyrës ndërtohet përmes një diskutimi të plotë me të gjithë vendimmarrësit për të identifikuar fushat e ndikimit, planet strategjike dhe iniciativat e ndërmarra nga të gjitha institucionet dhe për të koordinuar përpjekjet në kuadër të programeve kombëtare. Bashkëpunimi parashikohet të sjellë qartësimin e hapave të nevojshëm për orientimin e aktivitetit financiar drejt një financimi të gjelbër dhe kalibrimin e kërkesave sasiore, nëse një sipërmarrje e tillë do të konsiderohet e nevojshme.

8. REFERENCA

Battiston, S., Mandel, A., Monasterolo, I., Schütze, F., & Visentin, G. (2017). A climate stress-test of the financial system. *Nature Climate Change*, 7(4), 283–288. <https://doi.org/10.1038/nclimate3255>

BCBS (2022). *Principles for the effective management and supervision of climate-related financial risks*. Bank for International Settlements, June.

Boissinot, J., Goulard, S., Le Calvar, E., Salin, M., Svartzman, R. and Weber, P.-F. (2022). *Aligning financial and monetary policies with the concept of double materiality: rationales, proposals and challenges*. INSPIRE Policy Briefing Paper 05, June.

CCKP. (2021a). *Albania*. Climate Change Knowledge Portal. <https://climateknowledgeportal.worldbank.org/country/albania>

Climate Risk Profile: Albania (2021): The World Bank Group

Grippa, P., Suntheim, F., & Schmittmann, J. (2019). Climate Change and Financial Risk - Central banks and financial regulators are starting to factor in climate change. *Finance & Development*, 56(4).

IMF. (2021). *Climate Change Dashboard*. <https://climatedata.imf.org/pages/finicators/#fi3>

IMF. (2022). *Financial Soundness Indicators (FSIs)*. International Monetary Fund. European Department (Series). <https://data.imf.org/?sk=51B096FA-2CD2-40C2-8D09-0699CC1764DA>

Monasterolo, I. (2020). Climate change and the financial system. *Annual Review of Resource Economics*, 12, 299–320. <https://doi.org/10.1146/annurev-resource-110119-031134>

NGFS. (2019). *A call for action - Climate change as a source of financial risk (Issue April)*. Network for Greening the Financial System. https://www.ngfs.net/sites/default/files/medias/documents/ngfs_first_comprehensive_report_-_17042019_0.pdf

NGFS (2020). *Guide for supervisors - Integrating climate-related and environmental risks into prudential supervision*. Network for Greening the Financial System Technical document, May. (link)

NGFS. (2021a). *NGFS Climate Scenarios for Central Banks and Supervisors: Vol. June*. Network for Greening the Financial System. https://www.ngfs.net/sites/default/files/medias/documents/820184_ngfs_scenarios_final_version_v6.pdf

NGFS. (2021b). *Progress report on bridging data gaps (Issue May)*.

Republic of Albania. (2016). *Intended Nationally Determined Contribution (INDC) of the Republic of Albania following decision 1/CP.19 and decision 1/CP.20*.

Republic of Albania. (2021). *Albania Revised NDC*. UNFCCC. <https://www4.unfccc.int/sites/ndcstaging/Pages/Party.aspx?party=ALB&prototype=1>

Topalli, & Monnin (2023). *Climate Risks in Albania and their Relevance to the Central Bank*. SUERF Policy Brief, No 541. https://www.suerf.org/docx/fcae2be3a60e8d453ec372274f39ad13c_63117_suerf.pdf

UNDP. (2021). *UNDP helps Albania meet obligations deriving from Paris Climate Change Accord*. United Nations Development Programme. <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/presscenter/pressreleases/2019/undp-helps-albania-meet-obligations-deriving-from-paris-climate-.html>

ECB sets deadlines for banks to deal with climate risks (europa.eu)

Supervisory assessment of institutions' climate-related and environmental risks disclosures (europa.eu)

ANEKS 1

INICIATIVAT NDËRKOMBËTARE

Më poshtë paraqiten iniciativat dhe marrëveshjet aktuale historike ndërkombëtare për luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj një bote me temperatura më të larta (Protokolli i Kiotos, Axhenda e OKB-së 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Marrëveshja e Parisit për Klimën etj.) dhe një rrugë drejt një zhvillimi me karbon të ulët dhe rezistent ndaj klimës.

Ngjarjet kryesore në lidhje me klimën globale

- 1987 – Protokolli i Montrealit.
- 1992 – Krijimi i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) në Samitin e Tokës, mbajtur në Rio de Janeiro (Brazil), hyri në fuqi më 1994.
- 2000 – Samiti i Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.
- 2005 – Hyri në fuqi Protokolli i Kiotos për funksionalizimin e UNFCCC.
- 2006 – Stern, N, "Ekonomia e Ndryshimeve Klimatike: The Stern Review", Cambridge University Press, Kembrixh
- 2009 – Obligacioni i parë jeshil i listuar në Bursën e Londrës nga Banka Botërore.
- 2010 – COP10, Konventa mbi Biodiversitetin në Nagoya.
- 2012 – U krijua Green Investment Bank, duke u bërë institucioni i parë i tillë në botë.
- 2012 – Samiti i Rio+20 – Konferenca e OKB-së mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm (UNCSD).
- 2015 – Mark Carney mban fjalimin e tij "Të thyejmë tragjedinë e horizontit" në Lloyd's të Londrës dhe drejton themelimin e Task Forcës për Zbulimet Financiare të lidhura me Klimën (TCFD) si Kryetar i Bordit të Stabilitetit Financiar.
- 2015 (dhjetor) – 196 pjesëmarrës (195 shtete dhe Bashkimi Evropian) miratuan Marrëveshjen e Parisit për të vendosur një objektiv për kufizimin e ngrohjes globale nën 2 gradë celsius (°C) mbi nivelet paraindustriale dhe për të ndjekur përpjekjet për të kufizuar rritjen e temperaturës deri në 1.5°C mbi nivelet paraindustriale. Në këtë Marrëveshje u bë e njohur gjithashtu se ndryshimet klimatike përfaqësojnë një kërcënim urgjent dhe potencialisht të pakthyeshëm për shoqëritë njerëzore dhe planetin dhe se do të kërkohen reduktime të thella në emetimet globale të gazit serrë (GHG) për të arritur këtë qëllim. Ajo gjithashtu synon t'i bëjë flukset financiare të jenë të qëndrueshme drejt emetimeve të ulëta të GS²⁷ dhe zhvillimit të qëndrueshëm ndaj klimës.

²⁷ Gazra serrë.

- 2015 – Situata në OKB (2015). Sistemi financiar për të cilin kemi nevojë: Përafrimi i Sistemit Financiar me Zhvillimin e Qëndrueshëm. www.unepinquiry.org/wp-content/uploads/2015/11/The_Financial_System_We_Need_EN.pdf
- 2018 – Rrjeti për Gjelbërimin e Sistemit Financiar (2018). Takimi i parë i Bankave Qendrore dhe rrjetit të Mbikëqyrësve për Gjelbërimin e Sistemit Financiar (NGFS) më 24 janar në Paris.
- 2018 – Plani i Veprimit i BE-së për Financimin e Rritjes së Qëndrueshme.
- 2019 – Udhëzime të reja për raportimin e informacionit të lidhur me klimën e korporatave, si shtesë e udhëzimeve ekzistuese për raportimin jofinanciar (Direktiva e raportimit jofinanciar – 2014/95/BE), të cilat mbeten të zbatueshme.
- 2021 – Strategjia e përditësuar e financave të qëndrueshme të BE-së.

KUADRI LIGJOR I BE-SË

Plani i Veprimit për Financat e Qëndrueshme të BE-së u prezantua nga Komisioni Evropian në maj 2018²⁸, si pjesë e përgjigjes së BE-së ndaj Marrëveshjes së Parisit mbi Klimën. Tre shtyllat e tij kryesore janë:

- “Taksonomia” e BE-së për të zhvilluar veprimtari të qëndrueshme;
- Raportimi mbi qëndrueshmërinë në BE për kompanitë jofinanciare dhe financiare; dhe
- Grupi i mjeteve të investimit (përfshirë normat e referencës, standardet dhe etiketimet).

Që nga viti 2018, strategjia e financimit të qëndrueshëm të BE-së është përditësuar, duke përfunduar punën e nisur sipas Planit të Veprimit 2018 për Financimin e Rritjes së Qëndrueshme. Konteksti i ri identifikon katër fusha kryesore ku nevojiten veprime shtesë:

- Financimi i tranzicionit të ekonomisë reale drejt qëndrueshmërisë (zgjerimi i kuadrit të Taksonomisë së BE-së);
- Drejt një kuadri financiar të qëndrueshëm më gjithëpërfshirës (aksesimi financiar i NVM-e, teknologjitë digjitale, sigurimet, investimet sociale, buxhetimi i gjelbër dhe shpërndarja e rrezikut);
- Forcimi i qëndrueshmërisë dhe kontributit të sektorit financiar (lufta ndaj fenomenit të shtirjes së kompanive që pretendojnë se në ushtrimin e veprimtarisë

²⁸ Komunikim i Komisionit “Plani i Veprimit: Financimi i rritjes së qëndrueshme”, COM(2018) 97 final, 8.3.2018.

- së tyre mbrojnë dhe mjedisin (greenwashing), përmirësimi i transparencës);
- Forcimi i ambicieve globale.

Në fund të vitit 2023, Komisioni do të raportojë mbi zbatimin e kësaj strategjie, duke mbështetur njëkohësisht në mënyrë aktive shtetet anëtare.

Lidhur me Eurosistemin, në shkurt 2021, ai ka rënë dakord për një qëndrim të përbashkët për investimet e qëndrueshme të lidhura me ndryshimet klimatike në portofolet e politikës jomonetare. Në këtë rast, qëllimi është fillimi i komunikimeve të hapura të lidhura me klimën brenda dy viteve.